

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7426 E mërkurë 31 Janar 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Çështja e detit është hapur edhe një herë duke shkaktuar furtunë në opinion, ku si gjithmonë ata që dëgjojnë më shumë janë tifozët, dhe në rastin shqiptar...

Vijon në faqen 20

Nga DRITAN HILA

Sekreti i marrëveshjes së detit



Opinion i Ditës

Një nga dy pikat kryesore të rrezimit të paktit të kufijve detarë me Greqinë nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2010 ka qenë mungesa ...

Vijon në faqen 21

Nga ERL MURATI

Pakti detar, të besojmë ERT-në apo ERTV-në?



Devi Kasmi



Domart Konjari

Pranga bashkëpunëtorit të Domart Konjarit, e nxori në pritë

Vrasja mafioze, si nisi përplasja mes shokut të Konomit dhe Devi Kasmit

Saga e atentateve që tronditën Tiranën, ja historia e viktimës i njohur si "fantazma"

Nga INA ALLKANJARI

Konfliktet për territoret e drogës që u pasuan nga plagosja e disa viteve më parë e Domart Konjarit në Spanjë, duket se kanë qenë arsyet e atentatit të ndodhur në Tiranë mbremjen e së hënës. Menjëherë pas ngjarjes policia ...

Në faqet 2-3

KOTZIAS: MARREVESHJA NE PRILL. BUSHATI: TE DYJA VENDET KANE INTERES

KUFIJTE DETARE, GREQIA: U ZGJERUAM ME 12 MILJE

Ministri i Jashtëm grek: Nuk e diskutojmë çështjen çame. Edi Rama: Hesapet e 70 viteve dimë t'i mbyllim me dinjitet në interes të Shqipërisë



(Në foto) Kryeministri Edi Rama dhe homologu i tij grek, Kotzias

Në faqet 4-5

"STUDIO E HAPUR"

Ministri Xhataj: Ka më shumë se 20 grupe mafioze. Rama s'ka përgjegjësi për Tahirin

Në faqen 3

"BE, E SHQETESUAR"

Basha me krerët e PPE: Rama i lidhur me krimin, zgjidhja qeveria antimafie

Në faqen 6

"ALDISONI, I PAMESHIRSHEM"

Tezja e Arielës: Në momentin e vrasjes më telefoni vajza, dëgjova ulërima

Në faqen 9

DY KESTET E PARA

Ish-të përndjekurit, lista e dytë me trashëgimtarët që do të marrin paratë

Në faqet 10-12

PRO AUSTRO-HUNGARISE



Paskal Milo: Kur Ismail Qemali e Noli u akuzuan si agjentë austriakë

Në faqet 18-19

Dyshime për hakmarrje, 53-vjeçari tentoi të vriste një person në qershor të 2016-ës

Sulmohet me kallash banesa e shokut të Aldo Bares

Autorët derdhën 60 plumba mbi shtëpinë e Arjan Aliços, bashkëshortja: U tmerruam

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm është sulmuar me breshëri kallashnikovi banesa e ish-anëtarit të bandës së Lushnjës, Arjan Aliço, i cili ndodhet në burgun e Rrogozhinës për një plagosje të ndodhur një vit më parë. Burime nga policia lokale



bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:00 në lagjen në "Skënder Libohova" të këtij qyteti. Mësohet se fatmirësisht nuk ka pasur persona të lënduar, por vetëm dëme materiale (dëmtuar dyer dhe dritare). Pas kryerjes ...

Në faqen 8

PRISHJA E PAZAREVE ATENTATI

Saga e vrasjeve që tronditën Tiranën, ja historia e viktimës i njohur si "fantazma"

Vrasja mafioze, si nisi konflikti mes shokut të Franc Konomit dhe Kasmit

Dyshime, 41-vjeçari plagosi Konjarin me 5 plumba në Spanjë

Ina Allkanjari

Konfliktet për terri-toret e drogës që u pa-suan nga plagosja e disa viteve më parë e Domart Konjarit në Spanjë, duket se kanë qenë arsytet e atentatit të ndodhur në Tiranë mbremjen e së hënës. Menjëherë pas ngjarjes policia e Tiranës shpalli në kërkim dhe referoi materialet në prokurorinë e Tiranës për 45 vjeçarin Domart Konjari si i dyshuar për vrasjen e Devi (Dëfrim) Kasmit. Dyshimet e policisë bazohen mbi faktin se Domart Konjari ishte një nga rivalët dhe kundërshtarët kryesorë të Devi Kasmit në fushën e trafikimit të kokainës në Spanjë dhe në Francë. Bëhet me dije se Konjari ishte person me rrezikshmëri, pasi bënte pjesë në një grup kriminal që merrej me trafikimin e kokainës në Europë nga vendet e Amerikës Jugore. Ai ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga drejtësia franceze si pjesëtar i një grupi kriminal të organizuar, që bënte trafikimin në sasi të mëdha të kokainës në Europë. Dyshohet se viktima Devi Kasmit kishte tentuar të vriste më parë në Spanjë Domart Konjarin, duke e lënë të plagosur. Përkishtë për shkak të hasmërive të vjetra kriminale me Domart Konjarin viktima kishte ndërruar emrin nga Dëfrim në Devi Kasmit. 41-vjeçari njihje me pseudonimin Dëfrim "qorri". Ai njihje ndryshe edhe si "fantazma". Kjo nofkë mendohet të jetë vënë pasi për Devin nuk qarkullonin foto dhe shumë pak persona ia njihnin fytyrën. Dëfrim Kasmit ka qenë i përfshirë në trafikun e kokainës në Francë dhe në Spanjë. Pista ku po heton policia për vrasjen e tij, është ajo e hakmarrjes për shkak të kontrolleve për terri-toret në Evropë. Trafiku i drogës dhe historia e vrasjeve kanë rrethuar vazhdimisht 41-vjeçarin.

SAGA E VRASJEVE

Mësohet se Domart Konjari, Dëfrim Kasmit dhe Franc Konomi kanë qenë miq të ngushtë me njëri-tjetrin dhe trafikonin kokainë nga Amerika e Jugut drejt Spanjës dhe Francës. Më pas miqësia mes tyre u prish për shkak të një konflikti dhe shkak për këtë ishte Franc Konomi. Ky i fundit u vra në një atentat mafioz në vitin 2010. Mendohet se grupi i Dëfrim Kasmit ishte prapa ekzekutim-



Viktima Devi Kasmit

GAZ MUÇA

Gaz Muça, i vrarë më 7 prill të vitit 1992, tre muaj pasi ishte kthyer nga Gjermania. Në atë kohë dy grupet rivale në Tiranë ishin ato të Gaz Muçës dhe Naim Zyberit. Ky i fundit arrestohet pas vrasjes së Muçës dhe del nga burgu gjatë trazirave të '97-ës.



NAIM ZYBERI

Në fund të vitit 1999, Naim Zyberit plagoset në Milano të Italisë dhe ekzekutohet në spital disa muaj pas vrasjes së Artur Gororit. Për vrasjen e Naim Zyberit, prokuroria italiane akuzoi Arben Gororin, vëllain e Arturit, i cili ndodhet në burg në Shqipëri.



ARTUR GRORI

Artur Gropi vritet me plumb në zemër para derës së shtëpisë më 2 korrik të vitit 1997. Për këtë vrasje akuzohet Naim Zyberit, i cili largohet më pas në Itali.

FRANC KONOMI

Domart Konjari, Dëfrim Kasmit dhe Franc Konomi kanë qenë miq të ngushtë me njëri-tjetrin dhe trafikonin kokainë nga Amerika e Jugut drejt Spanjës dhe Francës. Më pas miqësia mes tyre u prish për shkak të një konflikti dhe shkak për këtë ishte Franc Konomi. Ky i fundit u vra në një atentat mafioz në 8 korrik 2010.



it të Franc Konomit. Për të marrë hak, grupi i Domart Konjarit gjeti vendndodhjen në Spanjë ku po qëndronte Dëfrim (Devi) Kasmit. Domart Konjari së bashku me një shokun e tij të paidentifikuar tentuan ta vrasin. Dy palët u përleshën me njëri-tjetrin dhe Dëfrim Kasmit mundi t'i merrte pistoletën Konjarit. Këtë të fundit e la të plagosur, ndërsa mikun e tij e vrau. Që prej atëherë, ka pasur vazhdimisht hasmëri mes

Domart Konjarit dhe Devi Kasmit. Më 28 gusht të vitit 1998 është ekzekutuar Gentian Dervishi i njohur me nofkën "Gent Kadaifi" pranë "Shkollës së Kuge". Pas disa vitesh emri i Konjarit përmendet për vrasjen e ndodhur në vitin 2003 në qytetin Renne të Francës, ku u vra Erjon Murati për një mosmarrëveshje për trafikun e drogës. Në 3 gusht 2005 në kryeqytet, u ekzekutua Fatjon Naxhaku. Vrasja e tij ndodhi vetëm pak ditë

pasi ishte kthyer në Shqipëri, pasi ishte arratisur nga burgu në Spanjë. Sipas hetimeve franceze, thuhet se vrasja është kryer nga Konjari në shenjë vetëmbrojtjeje. Por ende kjo vrasje në Shqipëri është pa autor. Gjithashtu, Konjari dyshohet se është i përfshirë edhe në vrasjen me 16 plumba të francezit Gilbert Slik në vitin 2007 në Marsejë. Në qershor të 2010-s Domart Konjari i shpëtoi një atentati në Madrid, ku mbetet i vrarë shoferi i tij. Vetëm një muaj

pas këtij atentati të dështuar ndaj Konjarit, vritet në dalje të burgut në Aliacante të Spanjës francezi Alain Coellier, i njohur si Alani i vogël. Në korrik të 2010 një nga njerëzit më të afërt të Domart Konjarit u ekzekutua me makinën e tij. Dyshimet për këtë vrasje, sipas autoriteteve franceze, janë mosmarrëveshjet e bandave rivale për dërgimin e kokainës

në Spanjë. Por, gjithashtu, emri i Konjarit në dosjen franceze është i përmendur dhe me ekzekutimin e Gentian Gashit në nëntor të 2011 në Durrës. Më 14 korrik 2013, në Tiranë është ekzekutuar me armë Edmond Dervishi dhe dosja e vrasjeve, ku përfshihet si i dyshuar Domart Konjari, mbyllet me atentatin e djeshëm ndaj Devi Dëfrim Kasmit.



Vendi ku ndodhi ngjarja

Gjyqi i Domart Konjarit, avokati: Nuk kam dijeni për vendndodhjen

Ekzekutimi mafioz i Devi Kasmit rikthen në qendër të vëmendjes emrin e Domart Konjarit, njeriut që trazoi drejtësinë franceze dhe jo vetëm. Pas përplasjeve që shkaktoi në institucionet e drejtësisë shqiptare, në 2016 ai ia doli mbanë të dilte nga burgu. Ai akuzohet për trafik ndërkombëtar droge. Lirimi i tij në vitin 2016 nga Apeli i Krimeve të Rënda në Shqipëri solli dhe reagimin e ashpër të Francës, e cila kërkoi ekstradimin e tij, pasi e kishte dënuar në mungesë me 10 vite burg. Ambasadori francez në Shqipëri, në atë kohë reagoi ashpër ndaj drejtësisë shqiptare. Ambasada nëpërmjet një letre dërguar presidentit e kryeministrit vinte në dukje se ishin harxhuan miliona euro dhe dhjetëra e mijëra orë pune në Francë për të dënuar me 10 vjet burg Konjarin, të përfshirë në një rrjet gjigant trafik kokaine. Edhe ministri i Drejtësisë asokohe, Ylli Manjani e cilësoi këtë një turp për shtetin shqiptar. Manjani urdhëroi një inspektim për mënyrën se si u ndryshua masa e sigurisë ndaj Konjarit. Në dhjetor të 2016-ës, Prokuroria për Krime të Rënda kërkoi sërish caktimin e masës së sigurisë "arrest në burg" ndaj Konjarit. Më 17 janar 2018, Gjykata për Krimet e Rënda çeli procesin gjyqësor ndaj tij. Ndërsa policia deklaroi dy ditë më parë se ka emrin e vrasësit të 41-vjeçarit, Gjykata e Krimeve të Rënda zhvilloi dje seancën e radhës ndaj Konjarit, i cili dyshohet si kreu i një organizate kriminale, që kishte trafikuar sasi të mëdha kokaine e heroine në Marsejë të Francës. Në çelje të seancës në mungesë të të pandehurit, i cili jeton në arrati prej dy vitesh, prokuroria paraqiti listën me 28 dëshmitarë, që pritet të japin shpjegime në procesin ndaj të dyshuarit, ku 24 prej tyre janë të pandehur në procese të bashkëlidhura në Francë. Në përfundim të seancës, i pyetur për zhvillimet e orëve të fundit, ku emri i Konjarit lidhet me ngjarjen e rëndë, avokati Vladimir Meçe nuk pranoi të bënte komente, por theksoi se në dijeninë e tij, ai nuk ndodhej në territorin shqiptar. Ai ka deklaruar se nuk ka dijeni për vendndodhjen e Konjarit, i cili dyshohet të mos ketë lëvizur jashtë Shqipërisë pas lirimit më mars të vitit 2016.



Në Shqipëri janë më shumë se 20 grupe kriminale. Ato janë të shpërndarë nëpër territor. Tirana ka peshën më të madhe, më pas vijnë Vlora, Durrësi, Shkodra, Fieri Elbasani. Kryesisht për trafikun e drogës, për vrasje dhe për një serë veprash të tjera penale. Një pjesë janë në territorin shqiptar, një pjesë kanë qenë të larguar. Për hir të së vërtetës, një pjesë janë larguar së fundmi. Nuk ka të paprekshëm në këto grupe kriminale", kështu u shpreh mbremë në studion e Eni Vasilit, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. I pyetur për familje mafioze në vendin tonë, ai u shpreh se ekzistojnë 4 ose 5, apo më shumë familje të tilla. Për sa i përket goditjes së këtyre grupeve kriminale, Xhafaj theksoi se ky është një proces që kërkon kohën e vet. "Duhet një proces i gjatë për të identifikuar autorin e një ngjarjeje, do kohen e vet për të mbledhur provat për këto grupet krim-

"Ekstradimi i Nezar Seitit nuk e dëmton çështjen 'Habibaj'"

Ministri Xhafaj: Ka më shumë se 20 grupe mafioze. Rama s'ka përgjegjësi për Tahirin



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

inale të rrezikshme", tha ai. Ndërkohë ministri i Brendshëm foli për çështjen e Nezar Seitit dhe ekstradimin e tij në Itali. Ai u shpreh se nga pikëpamja e marrëdhënies juridike, nisur nga fakti i hetimit dhe kërkesës nga pala italiane, ekstradimi i Seitit duhet të bëhet. "Nga fakti që ka pasur hetim për per-

sonin në fjalë, duhet arsyetuar ndryshe. Ai është pjesë e grupit kriminal të hetuar në Katania. Nuk e kam parë dosjen në tërësinë e saj. Ka nisur një hetim Prokuroria e Durrësit për këtë çështje, i duhet lënë asaj në dorë. T'i japim mundësinë ta hetojë, të identifikojë problemet, përgjegjësitë", u shpreh Xhafaj.

Ndërkaq, ai foli edhe çështjen "Tahirin" dhe akuzat e ngritura nga opozita (PD-LSI) lidhur me këtë rast. "Edhe drejtësia është pjesë e shtetit, funksion i tij. Natyrisht, edhe ekzekutivi është pjesë dhe nuk i kundërvihet drejtësisë, ka përfunduar ajo kohë. Shteti nuk është Rama, ai është kryeministri, por jo shteti vetë. Edhe opozita është pjesë e shtetit", pohoi ministri i Brendshëm. Ai u shpreh se politika nuk i ndalon hetimet e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. "Mungesa e arrestit nuk e pengon prokurorinë të bëjë hetime, pasi z.Tahirin nuk ka imunitet për shkak të hetimit. Provat që solli prokuroria nuk ishin bindëse për masën 'arrest me burg'", tha Fatmir Xhafaj.

Gjendet motori me të cilin u larguan atentatorët. Policia sekuestron 3 kg kokainë në banesën e viktimës

Ekzekutimi i Kasmit, në pranga personi që e nxori në pritë

Në kërkim Domart Konjari, dyshohet të jetë vrasësi ose porositiësi i krimit

Ina Allkanjari

Arrestohet bashkë punëtori i Domart Konjarit, njeriu që e tradhëtoi Devi Kasën duke e nxjerrë në pritë. Lajmin e deklaroi Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj te "Studio e Hapur" në Neës 24. Sipas tij Konjari rezultoi person me rrezikshmëri të lartë kriminale dhe fakti që ka korrupuar dhe individë në gjyqësor ka sjellë probleme me drejtësinë Shqiptare dhe asaj Franceze. Burime nga Policia e Tiranës konfirmojnë se është gjetur edhe motori me të cilin u larguan autorët pas vrasjes së Devi Kasmit. Policia vijon operacion për arrestimin e autorit, i cili dyshohet se është Domart Konjari. Sipas burimeve policore, Konjari mund të ketë qenë në njërin prej tri roleve, si ekzekutor i drejtpërdrejt, si pjesëmarrës apo bashkëpunëtor në vrasje, ose si porositiësi i ekzekutimit. Viktima Devi Kasmi kishte pak kohë që ishte kthyer nga Spanja dhe për shkak të së kaluarës dhe aktivitetit të tij të dyshuar kriminal, bënte lëvizje të kujdesshme dhe nuk dilte pa armë. Por mbremjen e së hënës atentatorët e kanë pritur para pallatit në rrugën "Petro Cali", duke mos i lënë kohë të kundërvepronte.



I kërkuari Domart Konjari

DINAMIKA E NGJARJES

Rreth orës 18:44 të ditës së hënë uniformat blu janë njoftuar nëpërmjet një telefonate se në rrugën "Kongresi i Manastirit" ka të shtëna me armë. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar forca të shumta policie, ku ka rezultuar se në një rrugicë që lidhet me rrugën "Kongresi i Manastirit", në afërsi të morgut është vrarë me armë zjarri shtetasi Devi Kasmi, 41 vjeç. Nisur nga dinamika e ngjarjes, autorët e kanë gjurmuar viktimën deri në momentin kur është futur në rrugicën e ngushtë dhe të errët. Ngjarja e rëndë ka ndodhur 50 metra larg spitalit të Pediatriisë, në një rrugicë të ngushtë dhe të errët, ndërsa 100 metra më larg ndodhet godina e Shërbimit Informativ Shtetëror. Po

DËSHMITARËT

Autorët kanë qëlluar me 9 plumba shtetasin Devi Kasmi teksa dilte nga banesa e tij. Plumbat i kanë shkakuar 41-veçarit vdekjen e menjëhershme. Dëshmitarë okularë bëjnë të ditur se kanë qenë dy persona në një motor sportiv të shpejtë dhe me skafandra në kokë, të cilët kanë hapur zjarr ndaj Kasmit.

ashtu, thuhet se njëri nga atentatorët priste në motor dhe tjetri në këmbë, duke i zënë pritë viktimës. Zona ku ndodhi ngjarja nuk kishte kamera sigurie, pasi ishte një rrugicë pa ndriçim dhe pa biznese. Pista kryesore që po hetohet është ajo e konfliktive që ka pasur Devi Kasmi në të kaluarën. Viktima ka ndryshuar emrin, pasi më parë quhej Defrim. Dyshohet se viktima merrej me veprimtari kriminale dhe rezultoi një person i njohur për



druhej një atentati. Ndërkohë, e gjithë ngjarja është parë nga dy infermiere, të cilat kanë qenë duke kaluar në rrugën ku ndodhi atentati. Policia ka shoqëruar tre persona për t'i marrë në pyetje. Autorët mbeten ende në arrati, ndërkohë që policia ka ngritur postblloqe në akset hyrëse dhe dalëse të Tiranës. Sakaq, policia ka shpallur në kërkim Domart Konjari, si një ndër të dyshuarit kryesorë të këtij atentati. Nuk dihen ende pro-

vat që disponon policia e Tiranës në bazë të të cilave ka shpallur si të dyshuar Domart Konjarin, i cili edhe para kësaj vrasjeje ishte në kërkim ndërkombëtar për trafik të lëndëve narkotike. Nga pamjet filmike të sekuestruara në zonë duken vetëm 2 persona mbi një motor sportiv dhe të pajisur me skafandra. Atentatorët kanë studiuar zonën duke ngritur një kurth perfekt poshtë pallatit të Kasmit, ku jetonte me bashkëshorten dhe vajzën e mitur. Kasmi kishte më pak se 2 vite që ishte kthyer nga Spanja. Policia mbajti të siguruar vendngjarjen për rreth 16 orë dhe pas këqyrjes në dritë natyrale, gjeti dhe sekuestroi gjithsej 9 gëzhoja. Në shtëpinë e viktimës u gjetën 2.9 kg kokainë në gjendje të ngurtë, 100 gramë lëndë qese plastike dhe një armë automatike me silenciator, e fshehur poshtë një kolltuku. Ndryshe nga Konjari, Devi Kasmi ka një profil të ulët publik dhe nuk ka qenë i përfolur në media për aktivitetet kriminale. Në vitin 2009 ai është dënua nga Gjykata e Pogradecit me 1 vit burgim dhe 600 mijë lekë të vjetra gjobë për akuzën e "Falsifikimit të dokumenteve dhe pasaportës". Më pas Devi Kasmi ka mundur të fitojë lirinë kundrejt një garancie pasurore prej 5 milionë lekë të vjetra.

Njoftim për shitje me ankand III-të
 Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e debitorit V Gjikas, P Gjikas Pasuria që shitet në ankand përmbledhet nga:
 - "Apartament" me numër pasurie 31/2024-1-të faqe 160 Vot 44, në ZK 8602 me sipërfaqe 63.19 m² në Vlorë Ankandi i pasurisë fillon me gminim fillestar në masën 20.714, 40Euro
 Ankandi do të zhvillohet në datë 22.02.2018 ora 15:00, në Bulevardin "Gjergj Fishta" Pall shoqërisë "Gora" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5.Tiranë Ofertuesit duhet tërheqin dokumentacionin e të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit llir_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-ai.com.

PAKTI ME GREQINE REAGIMET

Ministri i Jashtëm grek: Nuk e diskutojmë çështjen çame

"Kufijtë detarë, zgjerohen 12 milje", Kotzias: Ramë dakord, firmosim në prill

"Pala shqiptare do korrigjojë tekstet nga pasaktësitë"

Kryediplomati grek, Nikos Kotzias ka bërë të ditur në një intervistë për televizionin shtetëror grek ERT se Shqipëria ka pranuar të zgjerojë zonën ujore greke me 12 milje. Kotzias tha për ERT se Shqipëria ka pranuar zgjerimin e zonës ujore greke në 12 milje detare nga bregu, maksimumi që lejohet nga Konventa e OKB për ligin e detit. Kotzias tha se shpreson që kjo marrëveshje të nënshkruhet deri në prill, kohë kur në Shqipëri pritet të vijë kryeministri grek Aleksis Tsipras. Sipas ministrit grek marrëveshja për zonat detare vjen pasi Athina dhe Tirana kanë bërë hapa të mëdha për të normalizuar dhe përmirësuar marrëdhëniet e tyre dypalëshe me një seri hapash të vullnetit të mirë. Kotzias theksoi ndër të tjera se Shqipëria ka marrë përsipër të korrigjojë tekstet shkollore nga pasaktësitë historike, që sipas tij janë shprehje irredentiste. Ai madje shtoi se ka një propozim të mirë të kryeministrit shqiptar Edi Rama për të furnizuar fëmijët e pakicës greke drejtpërdrejt me tekstet nga Athina, por nuk përcaktoi nëse këto libra do të shkruhen në greqisht apo shqip. Kotzias përhëndeti zhvillimet e fundit në Shqipëri, ku presidenti i dha shtetësinë shqiptare kryepeshkopit Anastas si dhe fillimin e zbatimit të marrëveshjes për identifikimin dhe rivarrimin e ushtarëve grekë të rënë në luftën e greko-italiane 1940-41. Së fundmi, i pyetur nga gazetari, ai mohoi prerë që Greqia të njohë ose të diskutojë çështje "çame", pavarësisht se Tirana dëshiron ta vendosë atë në tavolinë. Ministri i jashtëm grek deklaroi se negociatat dyvjeçare që po kryhen me këthjellësi, durim dhe këmbëngulje po sjellin rezultatet e duhura, zbardhi Balkanweb.

BISEDA
Nëdhëkohë, sipas korrespondentit të Ora News, Biseda në studion e televizionit grek ka qenë kjo:
I pyetur nga gazetari se çfarë po bëhet me Shqipërinë për zonat ekskluzive ekonomike, Kotzias është përgjigjur: "Ramë dakord".
"Ratë dakord?", përsërit gazetari.
"Po", përgjigjet ministri i Jashtëm grek.
Gazetari vazhdon me këmbëngulje: Pse ka bërë de-



Kryediplomati grek, Nikos Kotzias

EKSPERTËT

Ekspertë ligjorë në Athinë sqaruan dje, për median se gjithçka përcaktohet në Konventën për të Drejtën Detare të Montego Bay-t, ku thuhet se zona bregdetare, (përfshirë edhe ishujt shkëmborë), e një shteti nuk mund t'i kalojë të 12 miljet. Ekspertët thonë se kjo e drejtë të zbatohet në rastin e zonës detare me Shqipërinë, pasi ka rajone ku distanca ndërmjet dy shteteve shumë më e vogël se 12 milje.

Ministria e Jashtme shqiptare reagon për paktin detar me Greqinë

MEJP: Delimitimi i hapësirave detare, në interes të dy vendeve, ndarje e drejtë

Ministria e Jashtme e Shqipërisë reagoi dje, pas deklaratave të ministrit të Jashtëm grek, Kotzias, por edhe ndaj deklaratave të aktorëve politikë brenda vendit. "Duke marrë shkas nga reagimet e sotme (dëshme), të pabazuara në lidhje me procesin e diskutimeve në tërësi me Greqinë, e më posaçërisht për çështjen e delimitimit të hapësirave detare, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dëshiron të sqarojë opinionin publik se: Delimitimi i hapësirave detare është në interes të dy vendeve si për sa i përket përcaktimit përfundimtar të kufijve të ushtrimit të sovranitetit dhe të drejtave sovranë në këto hapësira, po ashtu në drejtim të shfrytëzimit ekonomik të tyre", thuhet në deklaratën e MEJP. "Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e rrezoi marrëveshjen e nënshkruar mes dy vendeve në vitin 2009. Në mungesë të një



Ministri i Jashtëm, Dimitris Bushati

marrëveshje mes tyre, që prej vitit 2013 palët kanë kryer një sërë diskutimesh eksploratore për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme për këtë çështje", thuhet në qëndrimin e Ministrisë së Jashtme. Sipas kësaj deklarate, "në këto diskutime qëndrimi i palëkundur i palës shqiptare ka qenë dhe mbetet lidhja e një marrëveshjeje për delimitimin e hapësirave detare bazuar në parimet e Konventës për të Drejtën e Detit ku të dy shtetet janë palë, praktikën

ndërkombëtare, vendim-marrjen e Gjykatës Kushtetuese dhe legjislacionin e brendshëm që do të mundësojë një ndarje të drejtë dhe të pranueshme për të dy palët". "Është ky qëndrim i palëkundshëm pika e nisjes për ekspertët që do të negociojnë me palën greke për këtë çështje. Çdo interpretim tjetër nga aktorët politikë është qëndrim dashakeq që synon të relativizojë, apo më keq, mohojë gabimet trans-hanike të së shkuarës", mbyllet deklarata e MEJP.

Gazetari: Dhe pastaj vijon shpallja e zonës ekskluzive ekonomike?
Kotzias: Zonën ekskluzive ekonomike mund ta



Kryeministri Edi Rama dhe homologu grek Tsipras

Holokausti, Bushati: Shqiptarët treguan vlerat, strehuan dhe mbrojtën hebrejtë

Ministria e Punëve të Jashtme ka përkujtuar në prill të diplomatëve viktimat e holokaustit hebre, një ndër ngjarjet më të errëta të historisë moderne. Ministri i Jashtëm, Dimitris Bushati, tha se shqiptarët kanë treguar vlerat e tyre, duke strehuar dhe mbrojtur hebrejtë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Holokausti, në kujtim të 6 mln hebrejve të vrarë brutalisht gjatë Luftës së Dytë botërore, është përkujtuar edhe si një kontribut i diplomatëve të huaj më mision në Shqipëri dhe anasjelltas për kontributin e tyre në shtetet respektive për strehimin e tyre. Gjatë pritjes me diplomatë, ministri Dimitris Bushati tha se Holokausti hebre është periudha më e errët e historisë moderne.

Deputeti i PS takon presidentin e Komisionit të Venecias

Buquicchio: Kultura politike shqiptare të mbështetet në dialog dhe jo bojkot

Presidenti i Komisionit të Venecias, Gianni Buquicchio vlerësoi reformën në drejtësi që po bëhet në Shqipëri. Gjatë takimit që deputeti socialist, Ervin Bushati zhvilloi në Strasburg, me delegacionin e "Venecias" vlerësoi edhe rolin që pati ky komision në forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Evropë, dhe më gjerë. Shqipëria ka një histori bashkëpunimi me Komisionin prej më shumë se dy dekadash. Përgjatë kësaj periudhe, Komisioni ka asistuar vendin tonë në udhëtimin e tij drejt forcimit të standardeve demokratike dhe shtetit të së drejtës. Gjatë takimit u fol mbi stadin aktual të ecurisë së këtij procesi, që synon largimin e anëtarëve të organeve të gjyqësorit që janë të korruptuar dhe të paafte. Bushati deklaroi se qeveria shqiptare, ka vullnetin e plotë për të zbatuar plotësisht reformën në drejtësi, e cila, jo vetëm do të kthejë besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë, por, gjithashtu, do të kontribuojë në përpunimin e agjendës evropiane të vendit, konkretisht me hapjen e negociatave për anëtarësim këtë vit. Nga ana e tij, Presidenti Z. Buquicchio nënvizoi nevojën e zhvillimit të kulturës politike, mbështetur në dialog që zhvillohet në kuadër të institucioneve të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe jo përmes bojkotit të Kuvendit.

shpallësh kur tjetri ka pranuar që, sidoqoftë, e ke të drejtën për 12 milje.
Gazetari: Domethënë e pranuan?

Kotzias: Po.
Gazetari: Kjo është e rëndësishme ministër.
Kotzias: Ka edhe gjëra të tjera të rëndësishme.



Darina Tanushi
Valentina Madani

PDIU dhe shoqata "Çamëria" kërkuar nga kryeministri Edi Rama dhe ministri i Jashtëm, informacione për atë se çfarë është diskutuar apo nuk është diskutuar fare për çështjen çame, gjatë bisedimeve Bushati-Kotzias. Në një deklaratë publike, PDIU dhe shoqata "Çamëria" u shprehën dje: "Duke ndjekur të gjitha hapat e duhura ligjore, padyshim edhe protestat e çdo formë tjetër të arsyeshme e demokratike, jemi gati t'ia u tregojmë se çështja çame ekziston e kërkon drejtësi europiane, por edhe çdokujt që mendon se mund ta përdorë sipas interesave të ditës apo të bëjë pazar me këtë çështje apo çdo 'Kali Troje' që harron që asnjë nuk mund të negociojë për ne, përveçse shoqatës 'Çamëria' dhe PDIU. Ndryshe, turpi i historisë dhe jo vetëm do të bjerë mbi çdokënd që mendon se mund të lozë, të bëjë pazar apo mund ta lërë apo marrë këtë çështje. Urojmë shumë si gjithë shqiptarët që ky të jetë Viti i Skënderbeut dhe jo i Hamzait!", u shpreh PDIU, në një deklaratë të përbashkët me shoqatën "Çamëria". Ndërsa, kryeministri Edi Rama, reagoi duke i cilësuar "patriotë me çizme". "Patriotët me çizme e camëristët të sapongjizur në kazanin politik e mediatic, pasi i lanë poturet për çerekshkulli varur në telin e fqinjët dhe harruan edhe detin në shtëpinë e tij, na janë ndër zurr sot flakë e zjarr për të bërë shkumb e hi qeverinë, në turrit e akuzave për tradhtit!", u shpreh dje Rama. "Janë të mjerë që meritojnë veç mëshirë, po kujt ndër ju shqetësohet prej çizmeve të patriotizmit të tyre pa din e as iman, i them bëjë durim edhe pak e prit, sa të shkrushen gjërat e zeza mbi të bardhë në dokumentet e marrëveshjes së re me fqinjin. Dhe ndërkohë mos dysho hiçfare se ne që ditëm t'i hapim me kurajë e dinjitet hesapet e 70 vjetëve me fqinjin, ne dimë edhe t'i mbyllim me dinjitet e mirëkuptim, në interes të Shqipërisë e të shqiptarëve pa dallim", garantoj kryeministri.

EMERGJENCAT

SHBA dhurojnë pajisje për FA, Xhaçka: Miku i mirë, në ditë të vështira

SHBA-të u dhuruan dje emergjencave civile të Shqipërisë ndihma me vlerë rreth 650 mijë dollarë. Në mjediset e Komandës Mbështetëse, ku prej 2 muajsh është ngritur Qendra e Pritjes dhe Administrimit të Ndihmave, ministria Xhaçka dhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara, Donald Lu, morën pjesë në dorëzimin e pjesës së parë të ndihmave. Ministria Xhaçka falënderoi vendet aleate për solidaritetin e treguar pas përmbytjeve të fundit, duke veçuar kontributin e Shteteve të Bashkuara për Forcat e Armatosura shqiptare. "Situata e vështirë që kaluam në muajin dhjetor tregoi mes të tjerash, solidaritetin mes miqsh dhe njëherësh edhe misionin e përbashkët për t'ju gjendur pranë me të pamundurave, në vështirësitë e shkaktuara nga moti e keq. Ambasador Lu, një shprehje e bukur e jona thotë: Miku i mirë njihet në ditë të vështirë", tha Xhaçka. Nga ana e tij, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu, vlerësoi kontributin e Forcave të Armatosura shqiptare në ndihmë të komunitetit. "Ne besojmë në heroizmin e FA të Shqipërisë dhe jemi krenarë që i mbështesim në misionin e tyre për të shpëtuar jetë brenda dhe jashtë vendit", - tha ambasadori Lu.

OPOZITA
PD-ja është kundër marrëveshjeve korruptive që janë në disfavor të Shqipërisë. Kreu i PD-së, Lulzim Basha, i sapo kthyer nga Brusselsi mblodhi mbremë grupin parlamentar të PD-së, ku diskutua çështja e marrëveshjes dypalëshe mes dy ministrave të Jashtëm, atij grek Kotzias dhe ministrit shqiptar, Ditmir Bushati. Demokratët e cilësuan paktin Kotzias-Buashti si korruptiv, në dëm të popullit shqiptar. Mësohet se deputetët janë shprehur kundër kësaj marrëveshjeje, e cila sipas tyre është kundër interesave të sh-

PD kundër: Marrëveshje korruptive, në disfavor të Shqipërisë

Pakti me Greqinë, Rama për çamët: Mbyllëm me dinjitet hesapet e 70 viteve

PDIU: Urojmë të jetë Viti i Skënderbeut, jo i Hamzait



Kryeministri Edi Rama

PROTESTA

Shoqëria civile ka lajmëruar një protestë ditën e shtunë në orën 11:00 para Kryeministrit. Në thirrjen që u drejtohet qytetarëve shqiptarë pa dallim feje, krahine e ideje politike thuhet: "Duke parë reagimet tuaja në lidhje me lajmin se qeveria e Shqipërisë i ka falur 12 milje në det Greqisë, e konfirmuar zyrtarisht nga ministri i Jashtëm i Greqisë, për mediat greke, vendosëm të thërrasim një protestë ditën e shtunë, më datë 3 shkurt, ora 11:00, tek Kryeministria".

Kryetarja e LSI: Për karrigen e tij, kryeministri shtet gjithçka

Monika Kryemadhi: Atë që nuk e bënë dot as diktaturat, po e bën Edi Rama

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se për karrigen e tij shtet gjithçka. Duke komentuar paktin detar me Greqinë, Kryemadhi u shpreh: "A ka më qartë se kaq?! Ky njeri për karrigen e tij shtet gjithçka. Nuk njeh as moral e as ndjesi për atdheun. Ky njeri pasi shkatërroi marrëdhënien me Greqinë, duke prishur kishat si në kohën e komunizmit, tani fal detin për pak mëshirë nga Greqia. Ky njeri ka shqyer edhe portat e Shqipërisë për të larguar rinjtë dhe për të sjellë gjithë plehrat e botës", shkroi Kryemadhi në rrjetin social "FB". "Dhe në fund e ka të qartë se shqiptarëve nuk u duhet më as deti, as mali, as fushat dhe asnjë pasuri tjetër, sepse kështu si e ka katandisur Shqipërinë, dëshira e çdo të riu është



PETRIT VASILI

"Kryeministri u çorë për kufirin detar me Greqinë, tani të largohet se gënjeu. Kryeministri ka klithur e ulëritur deri në neveri për çështjen e kufirit detar me Greqinë. Gjeti edhe tradhtarë e armiq të popullit. Po sot të gjithë mësuam se ujërat greke do të zgjerohen me 12 milje", reagoi dje kreu i grupit të LSI.

të largohet nga vendi. Ky satrap nuk pyet më për asnjë vlerë njerëzore, qytetarie apo atdhedashurie", tha më tej kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi. Sipas saj, "për të ka vlerë vetëm karrigia e tij, për të cilën po

paguajmë të gjithë çmimin me të shtrenjtë, atë të shitjes së territorit shqiptar. Atë që nuk e bënë dot as diktaturat dhe pushtuesit, Edi Rama po e nënshkruan me gjakftohtësi të madhe".

grupit që të vijojnë me reagimin e fortë në parlament dhe komisione si dhe të votojnë kundër projektligjit për aeroportin e Vlorës. Basha ka theksuar se duhet të mbahet fryma e protestës së 27 janarit. "Duhet të mbahet fryma e 27 janarit, reagimi të vazhdojë që të jetë po i fortë nga deputetët

në mbledhjet e komisioneve dhe seancën plenare", mësohet se është shprehur Basha. Më herët është mbledhur kryesia e grupit, ku mësohet se është diskutuar për projektligjin për aeroportin e Vlorës dhe dialogun me Greqinë, çështje që më pas u diskutuan edhe në grupin parlamentar të PD.

Negociatori i 2009-ës, pakti detar, Gerveni: Nuk mund të zbatohet distanca 12 milje

Kristaq Gerveni, një nga anëtarët e grupit negociator të marrëveshjes së vitit 2009 me Greqinë thotë se nuk ka sens deklaratat e Kotzias për zgjerim të hapësirës detare me 12 milje, kur në disa pjesë largësia mes dy vendeve është më e vogël. "Në rastin e pozicionit gjeografik që ka Shqipëria me Greqinë, nuk mund të zbatohet kjo distancë, 12 milje. Distanca 12 milje mund të zbatohet në ujërat detare që janë në det të hapur. Në kanalën e Korfuzit bie fjala, që është më pak se dy milje detare, sgaroq që 1 milje është 1 852 metra, pra më pak se 2 kilometra dhe aty ku Kanali i Korfuzit është më pak se 2 milje, nuk ka sens dhe tingëlton qesharake që të merret tani dhe të zgjerohet 12 milje detare. Në këto raste zbatohet vetëm neni 15 i kësaj konvente, që thotë se për vendet që janë përballë njëri-tjetrit dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të pasur mbi 12 milje, pra nuk janë më shumë se 24 milje larg njëri-tjetrit, atëherë hapësira ujore ndahet mes për mes. Dhe në marrëveshjen e 2009-ës, ne kemi zbatuar rigorozisht barazdistancën. Ne nuk mund të pengojmë një shtet që të mos deklarojë ujërat territoriale deri në 12 milje", tha Gerveni për TV "Klan".

INTEGRIMI AKUZAT

Kreu i PD takon drejtuesit e PPE: BE, e shqetësuar për ngecjen e reformës në drejtësi

Basha: Rama i lidhur me krimin, zgjidhja qeveria antimafie

Valentina Madani

Kreu i PD-së Lulzim Basha denoncoi në Bruksel lidhjet e qeverisë "Rama" me krimin e organizuar. Z.Basha gjatë takimeve me drejtuesit të lartë të Partive Popullore Europiane, konfirmoi se opozita mbështet plotësisht çeljen e negociatave të anëtarësimit mbi bazën e meritës. Por sipas tij ky proces po dëmtohet nga mosplotësimi i kriterëve kyç, siç janë lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, nga kapja e drejtësisë dhe sabotimi i reformës në drejtësi nga Rama me qëllim mbrojtjen e peshqve të mëdhenj të krimit me të cilët i bleu votat dhe maxhorancën ilegjitime. Basha konfirmoi qëndrimin e opozitës se zgjidhja politike për Shqipërinë është një qeveri antimafia e çliruar nga krimi, që do t'i japë vendit zgjedhje të lira e të ndershme. "Duket qartë se zëri i shqiptarëve të bashkuar më 27 janar kumbon fuqishëm edhe këtu në Bruksel në zemrën e Bashkimit Europian, në institucionet e Bashkimit Europian dhe në parlamentin Europian. Ka një shqetësim të jashtëzakonshëm të institucioneve europiane dhe të përfaqësuesve të vendeve anëtare për ngecjen e reformës në drejtësi dhe për kapjen e drejtësisë, e cila mishërohet nga rasti "Tahiri", -tha kreu i PD. Z.Basha pati takime me presidentin Joseph Daul, me zëvendëspresidentin dhe njëkohësisht kryetarin e Komisionit të Punëve të Jashtme në Parlamentin Europian David McAllister, me komisionerin Hahn, me kryetarin e Komisionit të Çështjeve Europiane në Bundestag Gunther Krichbaum, kryetarin e grupit parlamentar të PPE Manfred Weber etj. Në këto takime mbizotëroi shqetësimi për hapat e hedhur nga Edi Rama për kapjen e drejtësisë dhe devijimin e reformës në drejtësi, me qëllim kontrollin politik të drejtësisë për të mbyllur dosjen "Tahiri" dhe të tjera hetime kyçe për luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të drogës dhe korrupsionit qeveritar. Basha vuri në dukje se si rezultat i këtyre akteve nuk ka asnjë rezultat për arrestimin e bosëve të krimit dhe drogës, për çmontimin e narkobandave, konfiskimin e aseteve kriminale, apo të politikanëve dhe zyrtarëve

"Kryeministri hodhi në kosh vetingun"

AKUZA

Z.Basha theksoi se procesi i integritetit po dëmtohet nga mosplotësimi i kriterëve kyç, siç janë lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, nga kapja e drejtësisë dhe sabotimi i reformës në drejtësi nga Rama me qëllim mbrojtjen e peshqve të mëdhenj të krimit me të cilët i bleu votat dhe maxhorancën ilegjitime.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha gjatë takimit në Bruksel

"Votimi elektronik, jo në tryezën e bisedimeve"

Çuçi: Përdorimi i teknologjisë nuk rekomandohet, PD është tërhequr

Votimi elektronik online nuk është më një opsion në tryezën e bisedimeve mes mazhorancës dhe opozitës, për reformën zgjedhore. Bashkëkryetari socialist i komisionit të posaçëm, Bledi Çuçi deklaroi për Top Channel se pas konsultimit me ekspertët edhe opozita ka hequr dorë nga kjo kërkesë e saj. "Përdorimi online i teknologjisë është diçka që tashmë nuk rekomandohet. Po heqim dorë kushdo që e ka tentuar ta futë një gjë të tillë për shkak të sigurisë kibernetike në botë dhe opozita është vetëdijshme për këtë gjë", -tha ai. Çuçi tregon se me bashkëkryetarin tjetër të komisionit, demokratrin Bylykbashi, është në kontakt të vazhdueshëm, por ndryshimi i sistemit zgjedhor duket se është temë e tryezave të tjera. "Ai është një diskutim tërësisht politik, në sensin që duhet të ketë një



orientim të qartë, sidomos të forcave të mëdha politike në vend, nëse duhet ndryshuar një sistem apo jo, apo një nevojë nga poshtë për të ndryshuar sistemin aktual, gjë që sot nuk e kemi. Kështu që, edhe ne nuk e kemi adresuar si çështje më vete", -sqaron Çuçi. Ndryshe nga ata që shqetësohen për kohën që kalon, Çuçi mendon se fokusi duhet të jetë të cilësia. "Mendoj se më shumë



ISH-DEPUTETI

Ish-deputeti i PD-së, Ildir Xhomara, ndërroi jetë në moshën 68-vjeçare pas një sëmundjeje të rëndë. Ngushëllime për humbjen e Xhomarës shprehën dy ish-kryeministri Berisha, kreu i PD-së, Lulzim Basha dhe deputetja Dhurata Çupi.

shqetësim duhet të ketë që produkti të jetë sa më i plotë, më i saktë, me konsensus dhe vendimmarrja pastaj të jetë sa më e qëndrueshme. Për mua kjo ka më shumë rëndësi. Kohën e kemi", -shprehët. Bledi Çuçi nuk i druhet klimës politike. Sipas tij aksioni politik i opozitës e ka ngadalësuar pak ritmin e punës së komisionit, por pa e cenuar atë.

nga Shqipëria drejt Europës prej tij dhe më shumë emigracion i paligjshëm. Ky është produkti i Edi Ramës në raport me Europën." -tha



ARRESTIMI

Ish-kryeministri Berisha deklaroi dje në mbledhjen e grupit të PD se ministria e Drejtësisë, Gjonaj duhet që të arrestohet, pasi firmosi ekstradimin në Itali të anëtarit të grupit të "Habilajve", Nazer Seitit. "Ministria e Drejtësisë me ekstradimin që ka bërë duhet arrestuar në flagrancë. Ekstradimi ka qenë akti më i rëndë në drejtësi", mësohet të ketë thënë Berisha.

VOTA NË OKB



PD kërkoi mocionin debati, Ruçi: Seanca në 8 shkurt

Kuvendi i Shqipërisë do zhvillojë në tetë shkurt një seancë mocion debati për votën e Shqipërisë në OKB, pro rezolutës së Egjiptit dhe kundër propozimit të SHBA për të njohur Jerusalemin kryeqytet të Izraelit. Ishte kërkesa e PD-së për të debatuar në Kuvend mbi këtë qëndrim të Tiranës zyrtare. Pas depozitimit të kësaj kërkesë, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi thirrri dje Konferencën e Kryetarëve ku u vendos që seanca e mocionit të zhvillohet te enjten e 8 shkurtit. Vota e Shqipërisë në OKB, e cila shkoi pro rezolutës së propozuar nga Egjipti u interpretua nga opozita në Shqipëri si votë kundër SHBA-së. Megjithatë, marrëdhëniet mes dy vendeve, siç është shprehur kryeministri Edi Rama dhe ministri i Jashtëm, Bushati nuk cenohen nga ky qëndrim. Vetë presidenti Trump dhe ambasadorja e SHBA në OKB, Haley u shprehën se do mbajnë shënim vendet që votuan kundër Jerusalemit.

Miratohet në Komision Ekonomie çelja e negociatave për marrëveshje

Aeroporti i Vlorës, Ahmetaj: Buxheti do të paguajë 2.5 mln USD në vit

Për trafikun e munguar në Vlorë, subvencionim nga taksat

Ornela Manjani

Trafiku i munguar në Aeroportin e Vlorës do të mbulohet me para nga buxheti i shtetit. Shuma mund të arrijë deri në 2.5 milionë euro në vit. Shifra është bërë e ditur nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj gjatë diskutimeve të projektligjit për hapjen e negociatave për ndërtimin e aeroportit të ri. Drafti është miratuar me votat e mazhorancës dhe pro aeroportit votoi edhe deputeti demokrat, Agron Shehaj.

KOMISIONI
Kanë vijuar edhe gjatë ditës së djeshme diskutimet në Komisionin e Ekonomisë për projektligjin e ri, që i hap rrugën nisjes së negociatave për kontratën e ndërtimit të aeroportit të Vlorës. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj tha se numri i pasagjerëve do të jetë 600 mijë pasagjerë në vit për 2-3 vitet e para. Rritja e pasagjerëve pritet që të jetë 7% në vit. Ministri Ahmetaj tha se metodologjia që do të ndiqet për mbulimin e kostos së pasagjerëve do të jetë e njëjtë me atë të Aeroportit të Zagrebit. Sipas tij, parashikohet që kosto minimale e buxhetit për të subvencionuar trafikun e munguar do të jetë 2.5 milionë dollarë në vit, ndërsa nuk përmendi një shifër maksimale. Pjesën tjetër të risikut e merr përsipër vetë kompania. Rritja e konkurrencës nga vënia në funksion e aeroportit të ri, pas heqjes së monopolit të Rinastit



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

pritet që të ndikojë pozitivisht dhe në uljen e tarifave të biletave. Ndërsa, ministri i Energjisë dhe Infrastruktursë, Damian Gjinkuri ka përsëritur se qeveria po ndërmerr një risk minimal për projektin. Skeptik për projektin ka qenë deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku. Ajo ka pyetur dy ministrat se pse ky projekt nuk i nënshtrohet projektligjit të koncesioneve?

Lidhur me garancinë s'vranë për trafikun e munguar, ajo shtoi se sipas rregullores së BE-së, po thyhen rregullat se çdo ndikim financiar që vjen nga buxheti i shtetit që është në distancë më të vogël se 100 metra. Një tjetër shqetësim i saj ishte mungesa e përvojës së kompanisë turke. "Duhet që të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë në operim, nuk e plotëson kjo kompani këtë

Bashkoi votën me PS për aeroportin e ri, deputeti i PD sqaron arsyet e vendimit

Deputeti i Partisë Demokratike, Agron Shehaj, ka sqaruar votën pro në Komisionin e Ekonomisë për projektligjin për ndërtimin e aeroportit të ri në Vlorë. Përmes një statusi në "Facebook", Agron Shehaj thotë se vota pro ishte për aeroportin dhe jo aferën korruptive. "I siguroj se vota ime në seancë plenare do të jetë kundër kësaj aferë korruptive. Jam totalisht kundër mënyrës sesi do ndërtohet, sepse është qartësisht e lidhur me synimin e kësaj qeverie për të vjedhur në kurriz të qytetarëve", - thotë ndër të tjera deputeti demokrat.



Bashkëpunimi ALUIZNI-UK, në të gjithë vendin

Më datë 22 janar 2017, Drejtorja e Përgjithshme e ALUIZNI-t nënshkroi një marrëveshje me Ndërmarrjen e Ujësjetllës-Kanalizime në të gjithë vendin, për t'i dhënë këtij të fundit të drejtën të ketë akses në bazën e të dhënave të aplikuesve për legalizim. Sipas kësaj marrëveshjeje, çdo qytetar, abonent i UK-së, që do të kryejë procedurën e lidhje me Ndërmarrjen e Ujësjetllës-Kanalizime dhe që ka objekt informal, mund të kryejë të gjitha shërbimet pranë këtij të fundit, pa qenë nevoja të shkojnë në zyrat e ALUIZNI-t që të tërheqin vërtetim. Këto marrëveshje, që si fillim u bënë për abonentët e UK-së që kanë një ndërtim informal në Bashkitë e Tiranës, Kamzës dhe Vorës do të fillojë zbatimin nga data 31 janar 2018 në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Për këtë arsye njoftojmë të gjithë qytetarët e interesuar që duke filluar nga 1 shkurti, të mos u drejtohen sporteve të ALUIZNI-t, por të shkojnë pranë sporteve të Ujësjetllës-Kanalizim në qytetin e tyre. Ky bashkëpunim mes institucioneve ka si qëllim shmangien e sorollatjeve të qytetarëve nga një institucion tek tjetri dhe t'i përgjigjet me një hap konkret nisjes së qeverisjes për të ulur sorollatjet e qytetarëve dhe pakësimin e dokumenteve që u kërkojnë atyre për shërbime të ndryshme.

Doganat publikojnë listën

34 bizneset e tjera që përjashtohen nga falja

Drejtorja e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave Sektorit i Monitorimit të Borsat

Lista e subjekteve me vendim penal të formës së prerë.

Nr.	Dega Doganore	Emri Subjektit	NIPT-I
1	Gjyrokastër	A - E T	283113666G
2	Vlorë	AI PLICARTA	1.66418205G
3	Sarandë	Alba Oil shtpik Sarandë	K04103803T
4	Durrës	Alfred Idriz Gogaj	K.33710228T
5	Durrës	Alfred Ahmet Ahmeti	BF04080910
6	Durrës	Alfred Idriz Gogaj	A00000000H
7	Durrës	Alfred Gogaj	K.33710229E
8	Qafë-Thane	Arilim Xhevat Hidri	Z2391231
9	Scorë	Atilas	K.53929003K
10	Durrës	Beem	262903033H
11	Durrës	Fezlim Avdullia Lato	A00000000H
12	Durrës	Gjergj Mark Prela	K.98316501B
13	Vlorë	Hanan Merina-Kosovari	A00000000H
14	Durrës	Jon Eurotransport	K.11424041W
15	Durrës	Julian Edmond Loloci	A00000000A
16	Sarandë	Klementina Muhamet Bab	BF1023347
17	Kapshitiçë	Ladovim Fadil Solla	pa NIPT-I
18	Vlorë	Sabi	K.77327304K
19	Vlorë	Selilju	266828237U
20	Gjyrokastër	Standard-A	K67217617S
21	Kapshitiçë	Toni	K.53717027L
22	Gjyrokastër	Vernak	294834836C
23	Kapshitiçë	Vjekira Bamashi	L.1665661J
24	Durrës	Zemir Elzir Peca	A00000000H
25	Vlorë	ALGIB	L.16508201H
26	Vlorë	HEMA METAL	L.16514204J
27	Gjyrokastër	Alba Ela	273430641D
28	Durrës	Chrisan Foring Trade	K414118057G
29	Durrës	SOPRECO SRL	L.02719801D
30	Durrës	ISBERTA IMPEKS	K91424503A
31	Durrës	AL-TIN EXCEL	1199219080M
32	Durrës	COCKU 2002	K.54022804F
33	Durrës	UNIFIED COMPANY	K.92311011K
34	Durrës	GSA-SALLAUK	K41729561E

Seferi, nënvizohet se kjo listë ka dalë pas vlerësimit që ka bërë sektori i Monitorimit të

Borxhit si dhe në bazë të informacioneve të dërguara nga drejtoritë rajonale.

Janë me mijëra biznese dhe individë që kërkuar të përfitonin nga lehtësia ligjore e ndërmarrje nga qeveria për shuarjen ose fshirjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore. Por për të gjithë ata që janë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat, përfitim bëhet i pamundur. Edhe pse afati i përfitimit nga ligji ka përfunduar në 31 dhjetor 2017, përpunimi i aplikimeve nga ana administrative vijon dhe ende nuk është nxjerrë lista me emrat e atyre që përjashtohen. Ashtu sikurse ka ndodhur muaj pas muaji, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave publikoi edhe dhe listën me 34 biznese që nuk mundën të përfitonin nga amnistia, për shkak se janë të dënuar me një vendim të formës së prerë. Lista përfshin qytetin ku shtrton aktivitetin biznesi, emërtimin e subjektit, NIPT-in. Në shkresën e firmosur nga zëvendës drejtori i përgjithshëm i Doganave, Arben

KERKESE PER OFERTE

Riparim sere

CEED Albania si pjese e projektit te saj "Agro-Tourism Albania" te mbeshtetur nga USAID dhe Ambasada Suedeze, po kerkon oferta per riparime serash te thjeshta ne zonen e Murriqanit te Shkodres. Sera aktuale qe duhet riparuar ka permasa 40m X 33m.

Sera ekzistuese eshte e ndertuar me kollona betoni dhe e mbuluar me plastmas. Kjo sere mund te riparohet me te njejtin material (beton), ose me material tjetër (beton ose metal).

Nepermjet ketij njoftimi CEED Albania kerkon te mbledhe oferta teknike dhe financiare mbi mundesite e riparimit te kesaj sere.

Aplikuesit duhet te dergojne ne adresen: info@ceed-albania.org, brenda dates 7 Shkurt 2018, nje propozim per riparimin e kesaj sere ku te perfishijne: materialin, cilesine e tij, koston e punimeve, koston e montimeve/riparimeve si dhe ckrimin perfundimtar te faturuar te seres gati per perdorim.

Aplikuesit duhet te jene kompani te regjistruara ne Republiken e Shqiperise dhe te paisura me te gjithë dokumentacionin e lejuar per kryerjen e ketyre punimeve.

Dyshime për hakmarrje, 53-vjeçari tentoi të vriste një person në qershor të 2016-ës

Sulm me kallashnikov në banesën e anëtarit të ish-bandës së Aldo Bares

60 plumba mbi shtëpinë e Arjan Aliços, gruaja: Ishim në gjumë kur qëlluan, u tmerruam

LUSHNJË

Në orët e para të mëngjesit të djeshëm është sulmuar me breshëri kallashnikov banesa e ish-anëtarit të bandës së Lushnjës, Arjan Aliço, i cili ndodhet në burgun e Rrogozhinës për një plagosje të ndodhur një vit më parë. Burime nga policia lokale bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:00 në lagjen në "Skënder Libohova" të këtij qyteti. Mësohet se fatmirësisht nuk ka pasur persona të lënduar, por vetëm dëme materiale (dëmtuar dyer dhe dritare). Pas kryerjes së veprimeve hetimore para-prake, dyshohet se shënjestër e dy autorëve të



Alma Aliço duke folur për "GSH"

krimit kanë qenë gruaja dhe vajza e 53-vjeçarit Aliço, i njohur ndryshe Arti i Braçes. Mësohet se në momentin që u shënuan breshëritë e armës, në banesë ndodhej kryefamiljarja Alma Aliço bashkë me vajzën e saj, 51-vjeçarja dhe rrëfeu moment-

et e tmerrit për "Gazeta Shqiptare". "Në gjumë ishim. Ishim shtrirë të dhoma e gjumit. U tromaksëm dhe pastaj njoftuam policinë", tha 51-vjeçarja. Ndërkohë që plumbat kanë prekur edhe banesën e katit të dytë ku jeton një pensioniste. Policia

konfirmoi se në drejtim të shtëpisë së familjes Aliço janë qëlluar të paktën 60 plumba kallashnikov. Arjan Aliço (i cilësuar si një nga ushtarët e Aldo Bares), në banesën e të cilit u qëllua me kallashnikov, ndodhet në burg për tentativë vrasjeje. Ngjarje kjo e ndodhur në qershor të vitit 2016. Ai u arrestua në atë kohë, pasi qëlloi 10 herë me thikë një 36-vjeçar, pas një shërrë në lokalin e basteve, duke parë Europianin. Mësohet se pas ndeshjes Shqipëri-Zvicër, në një pikë bastesh, Aliço plagosi rëndë me thikë 36-vjeçarin Julian Sula. "Arjan Aliço, 53 vjeç, i dënuar më parë për vrasje dhe Xh.A., 24 vjeç, edhe ky i dënuar më parë për vrasje të mbetur në



Përplasen 2 mjete, vdes mësuesja 45-vjeçare, plagosen 4 të tjerë

KURBIN - Një i vdekur dhe katër të plagosur është bilanci i një aksidenti të rëndë automobilistik, që ndodhi mesditën e djeshme në aksin rrugor Lezhë-Milot. Mësohet se nga përplasia e dy automjeteve në afërsi të kryqëzimit të Patokut ka humbur jetën një 45-vjeçare në profesion mësuese. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se në aksident janë përfshirë një automjet tip "Fiat" me targa AA 935 IO që drejtohej nga viktima, A.K. dhe një automjet tip "Benz" me targa AA308KH, i cili drejtohej nga Bardhok Tuçi, 43-vjeç, banues në Sanxhak. Mësohet se në automjetin tip "Fiat" ishin edhe shtetaset E.Gj., rreth 38 vjeçe, E.C., rreth 35 vjeçe si dhe E.M., rreth 35 vjeçe, kolege të 45-vjeçares. Këto të fundit kanë mbetur të plagosura dhe janë dërguar në Q.S.U. Tiranë. Ndërsa, ka mbetur i plagosur edhe drejtuesi i mjetit tjetër, i cili është dërguar për ndihmë mjekësore në spitalin e Laçit. Menjëherë pas sinjalizimit për aksidentin, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Pas kryerjes së veprimeve hetimore para-prake, blutë pohuan se dyshohet që aksidenti ka marrë shkas, pasi drejtuesi i mjetit tip "Benz" po lëvizte në sensin e kundërt të rrugës.

tentativë, kanë qëlluar egërsisht të riun nga Lushnja, pasi Julian Sula dhe djali 24-vjeçar i Arjanit, Xh.A., janë përfshirë në një debat për shkak të ndeshjes dhe preferencave që kishin për fut-

bollistët e Kombëtares dhe rastet e humbura të lojës, - bëri të ditur policia. Ndërkaq, blutë pohuan se dyshohet që motiv i sulmit të djeshëm të jetë pikërisht kjo ngjarje.



JOB ANNOUNCEMENT

School Leadership Development Officer

Albanian-American Development Foundation (AADF) was created in 2009 by the Albanian-American Enterprise Fund with the support and encouragement of United States Agency for International Development (USAID) and the United States Government. The mission of AADF is to facilitate the development of a sustainable private sector economy and a democratic society in Albania, and to contribute to stability in Southeastern Europe.

Description

As part of the Education sector portfolio, AADF is currently implementing the "Center for School Leadership" (CSL) project with the aim to develop a model of programs and services for school leaders in collaboration with national and international expertise. Furthermore, the CSL aims to develop a framework that will train, certify, develop professionally and monitor school directors.

Duties:

- Under the guidance of AADF, the candidate will perform duties such as the following:
 - Support with the process of establishment of Center for School Leadership (legal documents, structure etc.);
 - Implement activities and initiatives that ensure the project goals are met;
 - Coordinate communication and collaboration with government offices and other various stakeholders;
 - Draft CSL strategic operation plans and allocate resources;
 - Lead business development efforts;
 - Perform any other duties as may be required.

Required Experience and Education

- Successful candidates will have:
 - Master degree in education, education management, management or any other relevant field;
 - Minimum of 5 years of professional experience in education sector;
 - Organization/ institute management experience is preferred;
 - Good knowledge in regards to the education system in Albania;
 - Good understanding of school leadership, training design and delivery are preferred;
 - Excellent communication and presentation skills;
 - Strictly ethical conduct;
 - Fluent in Albanian and English;
 - Able to start work immediately or within short notice.

Competencies or Personal Attributes

- Delivering Results - which includes focusing on customer needs and satisfaction, setting high standards for quality, monitoring and maintaining quality, working systematically, maintaining quality processes, maintaining productivity levels, and driving projects to results;
- Following Instructions and Procedures - including competencies like following directions, following procedures, time keeping and attending, demonstrating commitment, and complying with legal obligations;
- Adapting and Responding to Change - includes accepting new ideas, adapting interpersonal style, showing cross-cultural awareness, dealing with ambiguity;
- Coping with Pressures and Setbacks - comprises coping with pressure, showing emotional self-control, balancing work and personal life, maintaining a positive outlook, and handling criticism;
- Achieving Personal Work Goals and Objectives - entails achieving objectives, working energetically and enthusiastically, pursuing self-development, and demonstrating ambition.

Please reference the job title and send a Curriculum Vitae and a Motivation Letter to the following address: careers@aadf.org. Applications will be accepted only electronically and should not be dropped off at the office. All applicants will receive a confirmation that their electronic submission was received. However, only the shortlisted candidates will be contacted for an interview. The deadline for applications is **February 11, 2018 at midnight**.

Plagosi me armë 19-vjeçarin, arrestohet pas 4 orësh agresori

FIER - Një 19-vjeçar është plagosur me armë zjarri në fshatin Çlirim të Fierit. Ngjarja ka ndodhur mesditën e djeshme, ndërsa i plagosuri është transportuar me urgjencë në spital për ndihmë mjekësore. Mësohet se i ri Renato Gjokaj ka një plagë në këmbë, ndërsa policia deklaroi se ende mbeten të paqarta rrethanat e plagosjes. Aktualisht ai ndodhet në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën. Ndërkaj, ka zgjatur vetëm pak orë aratira e autorit të plagosjes së 19-vjeçarit. Pas më shumë se 3 orë kërkime, policia ka arrestuar autorin me iniciale E.H.. Sipas policisë, i ri dyshohet se në banesën e tij ka plagosur me armë zjarri adoleshentin. Nga kontrolli i ushtruar në banesën e autorit u zbuluan dhe sekuestruan dy armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak. Rrethanat e ngjarjes mbeten ende të paqarta, pritet që dëshmia e autorit të hedhë dritë më tepër mbi ngjarjen.

SHKURT

Godet me sëpatë në kokë 53-vjeçarin, në kërkim autori

SHKODËR - Një 53-vjeçar është goditur me sëpatë në kokë në fshatin Guri i Zi në Shkodër. Mësohet se i plagosur ka mbetur 53-vjeçari Smajl Dylli, i cili është goditur nga një bashkëfshatar i tij. Ai është transportuar në spital për të marrë ndihmë mjekësore dhe paraprakisht mësohet se ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se i plagosuri shiste peshk me biçikletën e tij në zonën e Gurit të Zi dhe ngjarja dyshohet se është shkaktuar pas një mosmarrëveshjeje. Dyshohet se autori i ngjarjes është Pal Plaoka, i cili është shpallur në kërkim.

I gjenden në makinë 150 kg kanabis, kapet 42-vjeçari

VLORË - Mbrëmjen e së hënës, policia e Vlorës ka sekuestruar brenda një automjeti furgon tip "Benz", një sasi prej 150 kg kanabis sativa. Mjeti ndodhej në fshatin Cerkovinë të Novoselës, i parkuar pranë banesës së shtetasit Ervin Zykaj. Në përfundim të veprimeve të para hetimore blutë arrestuan pronarin e mjetit, Ervin Zykaj, 42 vjeç, banues në Cerkovinë dhe ka shpallur në kërkim F.Gj., 30 vjeç, banues në Vlorë. Në cilësimin e provës materiale është sekuestruar lënda narkotike dhe automjeti. Vijon puna për dokumentimin e plotë ligjor për të tjerë persona të përfshirë në këtë veprimtari të kundërligjshme. Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë Vlorë për veprime të mëtejshme.

Drogë drejt Greqisë, 3 shqiptarë në pranga, 2 në kërkim

SARANDE - Një tjetër operacion antidrogë ndërkombëtar është finalizuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm, ndërsa u sekuestruan 81 kg drogë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se operacioni u ndërmor nga policia Kufitare e Sarandës në bashkëpunim të ngushtë me policinë greke të Igumenicës. "Më datë 29.01.2018, rreth orës 19:00, nëpërmjet oficerit të kontaktit të Komisarariatit Policisë Kufitare Sarandë është vënë në dijeni pala greke e Igumenicës se në drejtim të fshatit Vërvë të Sarandës, drejtimi i piramidave nr63-64, disa persona që dyshohet se transportonin lëndë narkotike, janë nisur në drejtim të shtetit grek. Si rezultat i shkëmbimit të informacionit dhe ndjekjes nga të dyja anët e kufirit, rreth orës 04:30, të dt.30.01.2018, në vendin e quajtur Parapatamo, zona e Filatit, nga policia greke janë kapur 3 shtetas shqiptarë së bashku me lëndën narkotike ku nga peshimi rezultoi se është 81 kg, ndërsa dy shtetas të tjerë duke përfutur nga errësira mundën të largohen. Personat e kapur me lëndë narkotike janë: A. N., 24 vjeç, nga Rrësheni, banues në Shëndëlli, Konispol; K.L.L., 23 vjeç, nga Cakrani, Fier; si dhe M.L., 26 vjeç, nga Peshkopia.

"Arielën e pashë vetë në morg, nuk di ç'të them se si e kishte katandisur. Jemi të shokuar"

"Aldisoni u tregua i pamëshirshëm me mbesën time"

Nadire Lushi: Në momentin e vrasjes më telefonoi vajza, dëgjova ulërima

LUSHNJE

Aldison Belulaj është treguar i pamëshirshëm me mbesën time, Arielën. Pavarësisht lutjeve të saj, të së motrës dhe vajzës sime, ai ka shkrepur armën dhe e ka qëlluar për vdekje. Unë kam shkuar në morg dhe kam parë trupin e masakruar të mbesës. Jemi të shokuar nga kjo që ndodhi". Kështu deklaroi dje teza e 21-vjeçares, Ariela Murataj, e cila u vra me dy plumba pistolette nga Aldison Belulaj. Reagimi i Nadire Lushi nga Lushnja ka ardhur një ditë pas varrimit të 21-vjeçarit nga Zharreza e Fierit, i cili më 21 janar ekzekutoi vajzën me të cilën donte të martohej dhe më pas qëlloi edhe veten. Me lot në sy, teza e Ariela Muratit tregoi për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se si e mori vesh lajmin e kobshëm të vrasjes nga e bija, dëshmitare e ngjarjes së rëndë që ndodhi në Tiranë. Nadire Lushi tha se ka qenë vajza e saj (kushërira e Arielës), e cila e ka marrë në telefon në momentin që Aldison Belulaj i ka ndaluar në rrugë tri vajzat dhe ka kërkuar të bisedojë me Arielën. "Unë sapo kisha folur me vajzën kur ishin në shtëpi. Pas 10 minutash, ime bijë më mori në telefon, ndërsa dëgjova ulërimat: Mos na e vrisni motrën! Ishin të terrorizuara të dyja dhe s'dinin çfarë thoshin. Vajza ime thoshte: Do ta japim vetëm mos e vrit! Ai sa e kishte marrë, kishte nisur ta qëllonte. Ky e kishte kapur nga mbrapa, e kishte tërhequr Arielën, ndërsa ato bërtisnin për ta lënë, por ai i kishte qëlluar me plumb në këmbë dhe më pas u kishte drejtuar edhe atyre armën... Arielën e pashë vetë në morg, nuk di ç'tu them si e kishte bërë, pjesën e pasme të kokës nuk ma treguan", - pohoi teza e studentes së shkëlqyer të Drejtësisë. Ndërkaq, Nadire Lushi tha se, edhe pse tri vajzat kishin kërkuar ndihmë në momentin kur ndodhi ngjarja, askush nuk iu është përgjigjur thirrjeve të tyre. "Gocat kishin marrë në telefon 112-n se ishin paralamëruar se Aldisoni kishte shkuar në Tiranë me mendje të keqe. Po iknin në polici, veshur të dyja me xhiboks të zi", sqaroi Lushi. Sipas saj, Ariela ishte një vajzë që nuk kishte ndërmend të krijonte një lidhje dashurore, duke hedhur edhe një herë poshtë mundësinë se dy të rinjtë frekuentoheshin. "Teze unë dua të studioj, dua të jem dikushi", - mësohet t'i kishte thënë mbesa pak kohë më parë.

MOTRA VIKTIMËS

Bora Murataj rrëfeu dy ditë më parë në "Pasdite në Top Channel" momentin e vrasjes të së motrës, Arielës. "Më 21 janar isha në shtëpi bashkë me motrën kur morëm një telefonatë nga djali i dajës, i cili na tha se Aldi ishte nisur për në Tiranë me mendje të keqe. U telefonuam prindërve dhe më pas tentuam të lidheshim me policinë, por nuk na u përgjigj. Aldisoni na preu rrugën, e kapi motrën time për dore dhe e qëlloi me pistoletë në këmbë. Motra uili kokën nga dhimbja, s'e pashë ku mori plumbin tjetër", tha 19-vjeçarja.



Teza e Arielës, Nadire Lushi, duke folur për "GSH"



Ariela Murataj



Kushëriri i Arielës, Saimir Dine duke folur për "GSH"

Kushëriri i Arielës: Jo hasmëri me familjen e Aldisonit, kjo histori është mbyllur

LUSHNJE - Në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur 10 ditë më parë ka folur edhe kushëriri i Arielës, Saimir Dine. Ai ka hedhur poshtë mundësinë e ndonjë hakmarrjeje të mundshme mes dy familjeve. Në një intervistë për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare", ai u shpreh qartë se kjo histori ka marrë fund. "Asnjëherë, kjo muhabet mori fund me ikjen e motrës sonë. Ne nuk duam më humbje njerëzish të dashur. Të gjithë kemi nëna, motra e vëllezër, por duhet t'i respektojmë ata", tha Dine. Sipas tij, familjet jo vetëm që nuk kishin dijeni për ndonjë lidhje, por edhe kërcënimet dhe presionet e vazhdueshme të Aldisonit i kishin marrë vesh 10 ditë para vrasjes makabre. Gjithashtu, i riu pohoi se ata ishin informuar mbi presionin e ushtruar nga 23-vjeçari rreth 10 ditë përpara ngjarjes dhe nuk kanë mundur dot të bëjnë asgjë. "Na ra si bombë kur dëgjua që Ariela kishte lidhje. Ajo gjithmonë thoshte unë dua të mbaroj shkollën, pastaj të mëndoj për jetën. Nuk ka pasur shanse të kenë qenë të lidhur. Unë motër vetë nuk kam, Arielën e kisha si motër, ndaj ajo do ma kishte treguar... Por kjo jetë gjenka ndryshe, të keqen nuk e ditke. Ariela asnjëherë s'na ishte ankuar për të, për shkak të kërcënimeve që i bënte deri në momentin kur i arriti kulmi, vetëm para 10 ditësh, para se ta vriste. Nuk ka ligj në botë që t'i thotë ai, sot në shekullin e 21-të: marthohe me mua se dua unë... Fjalë nuk ka, dhimbja është e madhe si për ne, edhe si për ata", tha kushëriri i viktimës.

Vrasja e studentes, ish-drejtuesi i policisë

Mithat Havari: Telefonata për ndihmë ishte sekondare

TIRANË - Ish-drejtuesi i lartë i Policisë së Shtetit, Mithat Havari ka folur dje në studion e "News 24" në rubrikën "Opinion" për situatën në vend, krimet dhe aksidentet. Ndër të tjera, ai u ndal tek vrasja e studentes Ariela Murataj nga Aldison Beluli. Nisur nga deklaratat e motrës, kushëriritës dhe të afërmeve të tjerë të viktimës se kanë telefonuar policinë për ndihmë, ish-drejtuesi i policisë tha se telefonata e tyre ka qenë sekondare, pasi ka qenë vonë. Ndërkaq, Havari u



shpreh se çelësi është parandalimi i krimit, duke këmbëngulur për punën e inspektorëve në terren, tek njohja e personave të rrezikshëm.

"Armët kanë rënë në duart edhe të njerëzve si atij djalit që vrau atë studenten. Të marrësh përsipër të thuash s'do ndodhte po të isha unë, do isha një megalomani i madh. Ne mundoheshim, punonin fort për parandalimin. Duhet të punojnë strukturat. Telefonatat e tyre kanë qenë sekondare, ka qenë gati e vdekur. Nga vendi i ngjarjes deri tek komisarati 4, e kam parasysh distancën deri sa të vinte policia, ai e kishte mbaruar misionin. Çelësi është parandalimi i ngjarjeve".

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përmbartimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 12 shkurt 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përmbartimore do zhvillohet ankandit i ri për shpëtim dhe të parcalloje të ndodhura në L.13, ZK.8518, Plazh, Durrës e konkretisht pasuritë nr.5854 vol 17, fq.2, 5856, fq.3, 5857, fq.4. Cdo truall ka sipërfaqen prej 600 m² dhe më të rëndit një marrëveshje sipërmarrje.

Çmimi fillestar më të cilin hapet ankandit do të jetë:
1) për pasurinë 5854 është 570020 Euro; 2) për pasurinë 5856 është 570020 Euro; 3) për pasurinë 5857 është 198892 Euro.

P.s: Çfytëtarët/suqjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet të jetë e derdhor në BKT, nr.ilogarisë Saimir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 4206 4204 98CL PRLCALLA).

EPSPA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- 1- Apartament** me nr.5/131+1-20, Zk.8532, vol.12, fq.60, me sip.98 m² e ndodhur ne Lgj."15 Tetor", P.25, Sh.11, K.1, Ap.N, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandit është** 3,920,000 (tre milion e nëntëqind e njëzetë mijë) Lekë.
- 2- Njesi** me nr.4/122+1-N, Zk.8533, vol.11, fq.188, me sip.40 m² e ndodhur ne Lgj."15 Tetor", P.25, Sh.11, K.1, Ap.N, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandit është** 4,000,000 (katër milion) Lekë.
- 3- Truall** me nr.52/34, Zk.3981, vol.9, fq.192 me sip.3020 m² e ndodhur ne Sheq, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandit është** 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë) Lekë.
- 4- Truall + ndërtesë** me nr.52/44, vol.12, fq.132, Zk.3981, me sip.truallit 6134 m² dhe me sip.ndërtese 2160.2 m² e ndodhur në Fshatin Sheq i Madh, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandit është** 59,440,000 (pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dyzetë mijë) Lekë.
- 5- Godinë** me nr.3/166, vol.11, fq.242, me sip.totale 290.6 m². Zk.8534 me vendodhje në Rr."Apollon", Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandit është** 51,064,000 (pesëdhjetë e një milion e gjashtëdhjetë e katër) Lekë.
- 6- Truall** me nr.108/35, Zk.1791, vol.10, fq.248, me sip.500 m² e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandit është** 2,720,000 (dy milion e shtatëqind e njëzetë mijë) Lekë.
- 7- Truall** me nr.108/36, Zk.1791, vol.10, fq.249, me sip.2000 m² e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. **Çmimi me të cilin fillon ankandit është** 10,400,000 (dhjetë milion e katërqind mijë) Lekë.

Ankandit për shpëtim e të gjitha pasuritë se sipërcituara do te zhvillohet ne date 13.02.2018, ora 16.00 ne seline e shoqerise EPSPA SHPK ne adresen Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

Përfituesit e kështit të parë dhe të dytë, dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ish-të përndjekurit, 2000 trashëgimtarët marrin paratë

Ornela Manjani

Rreth 2000 fëmijët dhe nipërit ish-të dënuarve politikë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme brenda tre muajve. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të parë dhe të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. "Lista me përfituesit të cilët janë në radhë për kështin e tyre të dytë, të cilët duhet të përditësojnë numrin e llogarisë bankare si dhe të dorëzojnë fotokopje të mjetit të identifikimit", - thuhet në njoftimin e djeshëm të Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave: Dorëzoni numrin e llogarisë dhe certifikatat

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë

që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një shkronjë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo

prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të cer-

tifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjyqësor që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve, që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

KESTI I DYTË

(Vijon nga numri i djeshëm)

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIA	CERTIFIKATE FAMILJARE	CERTIFIKATE TRUNGUT	DESHMI TRASHIGIMIE	PROKURE
Selfo	Asllani	Xhehel	Asllani			X	V	V	
		Mokbule	Asllani			X	V	V	
		Donka	Lumi			V	X	V	
		Xhezo	Asllani			V	V		
Zef	Nika	Katrine				X	V	V	
		Lulash				X	X	V	
			Tomis	Nika	V				P
			Zoze	Nika	X	X			
			Gjergj	Nika	X	X			
			Sofi	Nika	X	X			
		Nike				V			B
		Mhill				V	X	V	
			Mire	Nika	X	X			
			Edmont	Nika	V				V
			Rozafa	Nika	X	X			
			Bledi	Nika	X	X			
		Marje				V			P
Ugo	Xhoja	Meropi	Xhoja			V	V	V	
		Aleksander	Xhoja			V	X	V	
		Aksinja	Xhoja			V	V		
Kosta	Kondi	Marsanti	Kondi			X	V	V	
		Spiro	Kondi			V			P
		Stavruila	Koça			V			P
		Antilla	Gami			V			P
		Mihal	Kondi			V	V		V
Jorgji	Daja	Naun	Daja			X	V	V	
		Kostandina	Daja			X	V	V	
		Fanje	30/12/1925			X	X		
		Petro							
			Aleksander	Daja					P
			Llamber	Daja					P
			Viktor	Daja					P
			Fatmirë	Daja		V	V		V
Selm	Feza	Aishe	Feza			V	V	V	
		Zenel	Feza			V	X	X	
		Selme	Karaj			V			P
		Rabushë	Hysa			V	X	X	
		Fatime	Zhabina			V			P
		Musa	Feza			V	X	X	
		Xhemile	Koçi			V			P
		Imeti	Feza			V	V		V
		Mereme	Kasa			V			P
		Gjylë	Ceka			V			P
		Januz	Feza			V			P
Fitim	Agallu	Ahima (Xhewrije)	Salis			V	V	V	
		Pezja	Shehu			V			
		Rrapo	Agallu			V	V		
		Agathi	Koxhaj			V	V		
		Fitrik	Agallu			V	X	X	
		Jermine	Shehaj			V	V		
		Merashë	Zyberli			V	V		
		Nureidin	Agallu			V	V		
		Vasili (Ybi)	Caci			V	V		

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIA	CERTIFIKATE FAMILJARE	CERTIFIKATE TRUNGUT	DESHMI TRASHIGIMIE	PROKURE
Nhas	Luli	Shape	Gjehaj			V	V	V	
		Dielli	Prenga			V	V		
		Fite	Rudi			V	V	V	
			Age	Ndoci	X	X			
			Vera	Palaj	V	V			
			Mark	Rudi	V	X			
			Vasil	Rudi	V	X			
Llazo	Kaleja	Sofia	Kaleja				V	V	V
		Vasil	Kaleja			V			P
		Mihal	Kaleja			V	V		V
Razip	Kondaj	Mureskbe	Kondaj				V	V	V
		Nihat	Kondaj			V	V		P
		Elsabeta	Shehaj						P
		Kastriot	Kondaj				V	V	V
			Mamela	Kondaj	V	X			
			Artim	Kondaj	V	X			
			Mariqen	Kondaj	V				P
			Razip	Kondaj	V				P
			Xhehal	Kondaj	V				P
Shefqet	Mustafaraj	Zagoll	Mustafaraj				V	V	V
		Xhemal	Mustafaraj				V	V	P3
		Sullane	Mustafaraj						P2
		Ferdinand	Mustafaraj						P2
		Kujtim	Mustafaraj						P2
		Diri					Vfot	Vfot	P
		Shanko	Shehu						V
			Adriatika	Shehu	V	X			
			Violeta	Bojashi	V	V			
			Egerem	Shehu	V	X			
			Gramos	Shehu	X	X			
			Fitim	Shehu	V	X			
			Aleksander	Bojashi	V	V			V
			Arian	Mustafa	V	V			V2
			Sazan	Islami	V	V			V3
Theodhora	Leka	Dhimitra	Jakova			V	V	V	V
		Petro	Leka						ZV
			Vangjush	Leka					P
			Vani	Leka					ZV
			Ylli	Leka					P
			Vladimir	Leka					P
			Irma	Hako	X	X			
Jorgji	Gorishi	Martha	Anastasi			X	X	V	X
		Irome	Kondi					X	X
			Violeta	Konni			V		V
			Lilijana	Vredbo	V	V			
			Thomas	Asimiqi			V		
			Simon (Esa)	Kondi	V	V			
Hysni	Malaj	Teki	Maja				V		V
			Ervehe	Osmenaj	V				P
			Deko	Suhaj	V				P
			Fras	Mala	V				P
			Yeli	Mala	V	V			V
			Iqmet	Mala	V				P
			Ramazan	Malaj	V	X			
Dioniz	Maka	Frano	Maka				V	X	V
			Franceskua	Noga	V	V			

Metush	Kabashi	Lise							V	V-	V		
		Drita (Katerina)	Illi						X	V-	V	P	
		Andrea (Nevruz)	Kabashi						X	X	V		
				Majlinda	X	X							
				Kosta (Elston)	X	X							
				Esmeralda	X	X							
				Petro (Petril)								P	
				Xhimi (Shkolqim)		V	V					V	
		Reshep	Kuka	Bede	Kuka						V	V	V
				Aqif	Kuka						V	V	X
				Veli	Kuka		X	X					V
				Masfati	Kuka		V	V					P
				Ndërcim (Nerim)	Kuka		V	V					P
				Sanie	Kuka		X	X					V
				Zoje	Hysa		X	X					V
Aishe	Sula				X	X					V		
Xharie	Ndërcia				V	V					P		
Behare	Friska				V	V					P		
Prende	Shkartaj			Lush	Shkartaj						V	V	V
		Lazer	Shkartaj						V	V	V		
		Gjyste	Kopshiti								P		
		Jani	Zbogo	Urani	Zbogo						V	V	V
				Kalilo	Dhimitriadihi						V	V	V
				Aredhina	Gjokopulli						V	V	V
Hali	Turja			Selin							V	V	V
									V	V	V		
		Gjergj	Hysaj	Tom (Tomio)	Hysaj (Gjeshaj)						V	V	V
Aqilea	Janila			Arnulfi	Janila						X	V	V
		Aleksandra	Mehilli						X	V	V		
		Artadhi	Milo						X	V-			
		Sotire	Makoçi						X	V-			
		Fotina	Gjoni						X	V-			
		Shoshana	Bifsha						V	V-			
		Apostol	Cano	Sofia	Bado						V	V	V
Anastacia	Bel								V	V	V		
Foti	Cano								V	V	V		
Kristo	Cano								V	V	V		
Myzafer	Pipa			Fshime	Pipa						V	V	V
		Dode	Ndoci	Preng	Ndoci						V	V	V
Dad	Kola			Preng	Kola (Gjonmarkaj)						V	V	V
		Hajredin	Mece	Medin	Mece						V	V	V
Kadri	Muzhaqi			Mitat	Muzhaqi						V	V	V
		Rysem	Muzhaqi						V	V	V		
		Isnetë	Çakani						V	V	V		
		Sabire	Kondrashu						V	V	V		
		Bari	Likaj	Tofi	Likaj						V	V-	V
Fatime	Shenaj								V	V	P		
Haki	Turani			Fuat	Turani						V	X	V
		Orhan	Shqipëri	Turani	Turani						X	X	V
						</							

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 31 Janar 2018 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- "Zgjohu o millet...", ish-deputetja kërkon të ngrihet populli...
- Spiropali shkon e sëmure në emision, regjia ndërpret transmetimin
- Ironia e deputetit të LSI: "Peshku i madh" u "arratis"
- Rajmonda Bulku: Berisha na bëri njerëz, dyfishoi rrogat tona...

"The Sun" i dedikon shkrim këngës "Mall" të Eugent Bushpepës



Silvana Rusi:

Flet këngëtarja:
Ju rrëfej
prapaskenat e
"Këngës Magjike"
në ndarjen
e çmimeve



Ndahet Linda Rei?
Zhduken nga "Instagram"-i
fotot me biznesmenin



Këngëtarët 'big' nuk kanë besim në vetvete

"Së shpejti do të jem pjesë e një skene të madhe në SHBA"

Intervista

Flet këngëtarja: Ju rrefej prapaskenat e "Këngës Magjike" në ndarjen e çmimeve

Pamela Aliaj

Ajo është një nga zërat e rinj në fushën e muzikës shqiptare, e cila spikati me këngën "Ai" këtë vit, pjesë-marrëse si "New Artist" në "Kënga Magjike 2017". Silvana Rusi është një nga këngëtarët, e cila premtion shumë për muzikën dhe shumë shpejt do të jetë pjesë edhe e një skene më të madhe se ajo ku ka marrë pjesë deri më tani. Në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages", Silvana ka folur për eksperiencën e saj në "Kënga Magjike", prapaskenat e pathëna të artistëve që siç i quan ajo "big". Gjithashtu, ajo ka folur edhe për zhurmën e madhe që u bë për shpërndarjen e çmimeve që sipas shumë pjesëmarrësve ishin të pamërituara. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

Jeni një nga zërat e rinj që spikati në "Kënga Magjike" me këngën "Ai". Si nisi rruga për në botën e muzikës?

Unë e kam filluar muzikën shumë e vogël. Për herë të parë kam kënduar 9 vjeç tek zërat e rinj, festival për fëmijë.

Kënga ka qenë pasion i Silvanës apo ishte dikush që të shtyri të jesh pjesë e saj? Cila është muza juaj?

Muzika ka qenë dhe do të ngjete një ndër pasionet e mia më të mëdha edhe pse sot ajo është kthyer një profesion të mirëfillt për mua. Familja ka qenë shtyssa ime e parë që kur isha shumë e vogël, isha pjesë e pallatit të pionierëve. Muzë frymëzimi për mua është vetë muzika, më jep kënaqësi dhe frymëzim.

Keni marrë pjesë në konkurse të ndryshme muzikore si "Top Fest" apo edhe "Kënga Magjike" tani së fundmi. Cila ka qenë eksperiencia më e veçantë për ju?

Kam marrë pjesë në shumë festivale, spektakle e talent-show. Kam qenë në "Top Fest 9", "X-Factor", "Star Akademi" dhe së fundmi te "Kënga Magjike". Eksperiencia më të veçantë do të cilësoja "Star Akademi"-n dhe "Këngën Magjike". "Star Akademi" ka qenë konkurrenca imi imi parë në një talent-show dhe kishte shumë emocion, ndërsa "Kënga Magjike" ka qenë gara e parë me këngëtare me emër dhe ndjeja përgjegjësi.

Keni ardhur me baladë në këngën e fundit. Është një dedikim personal apo një frymëzim i autorit të këngës?

Kënga e fundit është realizuar nga Fifi si tekst dhe melodi dhe produksion i SM records. Frymëzimi ka qenë nga vetë Fifi dhe s'ka lidhje

Silvana Rusi:

Këngëtarët "big" edhe pse me talent, s'kanë besim në vetvete

"Së shpejti do të jem pjesë e një skene të madhe në SHBA"


me mua personalisht, por sapo e kam dëgjuar si këngë, e kam bërë timen.

Jeni duke punuar ndonjë projekt tani që prisni ta nxirrni në treg? Cila është kënga e radhës e Silvanës? Aktualisht kam dy materiale, të cilat po i punojmë fort

dhe sigurisht do të vijë edhe klipit shumë shpejt. Ndryshe nga herët e tjera, kaq mund të them.

Keni menduar për ndonjë bashkëpunim? Cili do të ishte, nëse po? Për momentin e kam menduar një të tillë dhe po diskutohet. S'mundem ta them emrin për shkak se ai është shumë i njohur dhe s'dua të prishet surpriza. A keni pasur oferta nga ndonjë shtëpi diskografike



Si ishte eksperiencia e pjesëmarrjes në "Kënga Magjike"? A patët pakënaqësi nga shpërndarja e çmimeve? "Kënga Magjike" ka qenë një super eksperiencë dhe do vazhdojë të marrë pjesë. Për sa i përket çmimeve, unë isha në kategorinë "New Artist" dhe sigurisht "big-eve" nuk ju hyjmë në sy, përveç disave. Pjesa e çmimeve si me meritë si pa meritë u takonte atyre. Kjo pjesë s'më pengoi fare. Unë isha



në Shqipëri apo Kosovë?

Oferta kam pasur nga shtëpi diskografike në Shqipëri plot, por jo me ndonjë influencë të madhe në treg dhe jam detyruar të mos pranoj. Cili është këngëtarit/ja që do të doje të kishe një duet apo bashkëpunim muzikor? Do pëlqëja një bashkëpunim me Stinen nga këngëtarët meshkuj.

aty të thosha që unë jam kjo. Cila është prapaskena që nuk ju pëlqeu në atë pjesëmarrje apo edhe në konkurset e tjera që keni vënë re rëndom? Thashë që ka këngëtarë "big" që se meritojnë atë status edhe pse kanë shumë talent. S'kanë besim në vetë. A ju kanë kërkuar ndonjë "shpërbllim" apo "përfitim"



këngëtar për të arritur vlerësimin e këngës kundrejt një favoriti?

Nuk kam hasur akoma, por të dëgjuara ka plot.

Cila ka qenë për ju një trampolinë për mundësi për të hapur dyer të tjera?

Po mund të them që "Kënga Magjike" ka qenë një trampolinë për mua. Duke qenë se mora pjesë atje, realisht pata shumë pëlqime dhe komente pozitive nëpër rrjetet sociale dhe arrita të shkoj deri në finale si "New Artist", edhe pse nuk e fitova çmimin "New Artist", fitova tjetër gjë. Nuk ka vonuar një muaj dhe mua më erdhi një ofertë nga Amerika nga një agjenci eventesh që organizon evente atje për shqiptarët e ShBA-së. Sigurisht kjo kish të ardhur si fryt i këngës

të ndonjë lloji këngëtarët e tjerë apo "juria" për të pasur vlerësim për këngën tuaj? Jo, nga juritë kurrë s'kam hasur në asnjë event. Nga këngëtarët, vetëm në "Kënga Magjike", e thashë, ata s'besonin në vetvete. Cili është rasti më flagrant që keni dëgjuar nga ndonjë

si me "Kënga Magjike" dhe duke qenë se këndoj live nuk e pata problem që të pranoja këtë ofertë. Unë kam nisur procedurat për dokumentacion dhe së shpejti do të jem atje edhe pse aktualisht punoj në një nga klubet më të njohura të Tiranës.



Transgjignorja Linda Rei, duket se i ka dhënë fund lidhjes me djalin e një biznesmeni zviceran. Ka qenë vetë ajo që e bëri publike në fillim edhe fejesën me të dhe çdo moment të kaluar duke e ndarë në faqen e saj në "Instagram" edhe momente intime. Por në "Instagramin" e saj duket se gjithçka ka përfunduar duke qenë se ajo ka postuar sërish fotot e vjetra duke fshirë çdo gjurmë të të fejuarit. Linda Rei ishte në një lidhje me djalin e një biznesmeni në Zvicër e bashkë ishin njohur në hotelin luksoz të atij, ku Rei po pushonte me mikën e saj. Por gjykuar edhe nga postimet e saj në rrjete sociale duket se Linda i ka dhënë fund kësaj fejeje. Dyshimet shtohet edhe më tepër me postimet me karakter erotik që zakonisht kanë në qendër reperin Noizy, si video e fundit ku kishte vendosur emrin e tij në mes të gjoksit. Megjithatë ajo nuk është shprehur lidhur me këtë fakt duke dashur të ruajë privatesinë e saj. Çfarë të ketë ndodhur midis tyre? Të jetë e vërtetë që Linda është serish single?

Ndahet Linda Rei? Zhduken nga "Instagram"-i fotot me biznesmenin

"The Sun" i dedikon shkrim këngës "Mall" të Eugent Bushpepës

Kënga "Mall" e Eugent Bushpepës do të performohet në natën e parë të Eurovizionit ndërsa vetë këngëtari ka thënë se do të jetë në versionin shqip të saj dhe jo në anglisht. Ndërkohë që prestigjiozja pëpa. Duket se edhe mediave të huaja u ka bërë përshtypje kënga e tek Eugentit këtë vit. Me pas shkrimi vijon me një përmbledhje të karrierës së Gentit në Shqipëri dhe, gjithashtu, me faktin se ai u për zgjedh fitues në festivalin e 56-të të Këngës nga një juri profesionist-këngën tonë të përfaqësuar nga një zë potent siç është ai i Eugentit në skenën prestigjioze të Eurovizionit. Sa emcione!

SUN ALL SPORT TV & SHOWBIZ NEWS FABULOUS MONEY MOTORS TRAVEL TECH DEAR DODRE TOP

HITTING THE RIGHT NOTES Who is Albania's Eurovision Song Contest 2018 entry? Eugent Bushpepa to perform Mall

Albania is pinning its hopes on Eugent Bushpepa, but will they be able to bring it home?

By Edward Stein

Wed, January 31st, 2018 | Updated: 2018, January 31st, 2018

ALBANIA are pinning their hopes on Eugent Bushpepa this year at the Eurovision Song Contest. The singer was selected by a professional jury to compete in Lisbon - who is he and what's his background? Here's all you need to know.



Save up to 30% Save money when you compare hotels prices on TripAdvisor




Pas një pritje të ëmbël prej 9 muajsh vjen në jetë para 2 ditësh, fëmija i parë i këngëtares seksi, Zaimina Vasjari, Khloe. Zai e bëri të ditur këtë lajm përmes disa postimeve në rrjete sociale si çdo moment tjetër gjatë këtyre 9 muajve. Krahas urimeve të shumta miqte e afert të këngëtares duket se kanë qenë të parët që kanë qenë me të në spital. Nder to kemi vënë re se në faqet e tyre sociale kanë shpërndarë urimet: modelja Françeska Jaçe, fotografi Luxhin Kurti dhe balerini Graciano Tagani. Ata kanë publikuar foto në rrjete sociale nga spitali ku Zaimina solli në jetë vajzën e saj. Nuk kishte se si të mungonte edhe fotoja e parë e bërë me shtrengim dore të vogëlushes nga i ati i saj, Klodian Asllani.

Sa shumë dashuri vetëm për vogëlushen Khloe

Elvana merr vendimin drastik pas 3 vitesh, vendos të bëjë këtë gjë pa Florin



Të gjithë mezi presim të dëgjojmë një varg recitalesh nga shumë këngëtarë live këtë vit. Një ndër to do të jetë edhe këngëtarja Elvana Gjata. Pasi u bë publik lajmi se, ajo do të mbajë një koncert më 3 shkurt, një tjetër e papritur vjen nga këngëtarja shqiptare. Siç ka bërë të ditur së fundmi në rrjetet sociale, ajo ka lënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe është rikthyer në Shqipëri, për disa projekte interesante. Këngëtarja do të mbajë në Tiranë për herë të parë një koncert recital dhe do të publikojë këngën e saj më të re, në gjuhën shqipe. Por, nga ana tjetër, pas 3 vitesh larg ekraneve shqiptare, Elvanën do ta shohim sërish në një intervistë televizive. Ndërkohë që intervista e fundit televizive e këngëtares ka qenë rreth 3 vite më parë, krah Flor Mumajesit. Ç'supriza presim të tjera nga këngëtarja?



Pas shkëlqim në ndarjen e çmimeve "Grammy 2018", këngëtarja e famshme Bebe Rexha është përballur me një ngjarje të frikshme. Nëpërmjet një postimi në "Instastory", ajo ka rrëfyer momentin e frikshëm që ka përjetuar në aeroport, ku thuhet është përplasa nga një taksist. "Thuhet se u përplasa nga një taksist sot në aeroport, teksa po kaloja rrugën e këmbësorëve. Po shikoja që të sigurohej dhe ai u bë i paduruar dhe erdhi vetëm një hap larg meje me qëllim. Kështu, mora cantën time të rënde YSL dhe e godita makinën e tij. Isha kaq e trembur dhe e inatosur, por duhet të bëjë kujdes me nervat", shkruhet në "Instastory"-n e publikuar nga Bebe Rexha.

"Tentuan të më shtypnin!" Këngëtarja shqiptare rrezikon jetën!

BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK



Spiropali shkon e sëmurë në emision, regjia ndërpret transmetimin

Nenkryetarja e Grupit Parlamentar të PS, Elisa Spiropali ishte e ftuara e mbërmbjes në edicionin e lajmeve drejtuar nga gazetarja Mirela Millori në ABCNews, por nisja e intervistës u shoqërua me një të papritur jo fort të këndshme për një transmetim 'live'. Ndonëse e sëmurë me grip, Spiropali sërisht ka qenë prezente në emision dhe kjo ka qenë e dukshme si pasojë e zërit të ngjirur, me hundë të bllokuara dhe kollitjes herë pas herë gjatë fjalës së saj. Në një moment,

Spiropali "mbytet" nga kollja dhe si për të dalë nga situata regjia ndërpret intervistën dhe transmetojnë një kronikë nga protesta e ditës së sotme e opozitës së bashkuar. Kronika ka zgjatur disa minuta dhe më pas Spiropali i është rikthyer intervistës normalisht.



"Zgjohu o milet...", ish-deputetja kërkon të ngrihet populli...

Ish-deputetja e PD-së, Arbjola Halimi shkruan se padrejtësisht është hapur konkurs pikërisht për vendin e punës që sipas saj duhet t'i përkiste asaj. Mes të tjerash ish-deputetja nuk kursen as ironitë për kryetarin e PD-së Lulzim Basha, ndërsa e 'falënderon' këtë të fundit për heshtjen. "Absurdi. Shpall vend të lirë pune në vendin ku duhet të kthehesha unë...! Zgjohu o milet kam qenë a skam qenë deputet. Gjithsesi nuk dorëzohem. Nuk është me garë për vendin e punës (të cilin ma ka neveritur), por se po u dorëzova unë, e mbrojtur me ligj të veçantë, me status të veçantë, çfarë i bie të bëhet me njeriun e thjeshtë?! Fim, o Lideri im, që më dole gjithë ky trim. Heshtja jote kumbon edhe aty në megrim", -shkruan zj.Halimi.

Ironia e deputetit të LSI: "Peshku i madh" u "arratis"

Deputeti i LSI, Luan Rama e cilësoi si skandal të paprecedentë ekstradimin e Nazer Seitit drejt Italisë. Ai kërkon hetimin dhe vendosjen para drejtësisë të të gjithë autorëve që organizuan dhe realizuan në bashkëpunim ekstradimin e paligjshëm, sikur e quan ai të "peshkut të madh". Nazer Seiti u ekstradua para pak ditësh në Itali në kuadër të dosjes 'Habilaj' ndërsa Prokuroria e Përgjithshme gjeti shkelje në këtë proces duke nisur hetimet për 4 prokurorë.



Rajmonda Bulku: Berisha na bëri njerëz, dyfishoi rrogat tona...

Aktorja Rajmonda Bulku ankohet se si funksionon aktualisht Teatri Kombëtar, pasi sipas saj, nuk i vlerëson aktorët. Sipas Bulkut, aktorët vlerësoheshin vetëm në kohën e Berishës. "Ka aktorë që thonë në 2005 na u bë rroga dyfish, u bëmë njerëz. Një aktor më ka thënë kam veshur kostum për herë të parë në jetën time. Ky ishte respekti që kishte në atë kohë kryetari i shtetit për artin. Mund të mos kishin mundësi financiare për të bërë teatër të ri apo godina që kushtonin, por të paktën artistit në teatër i dha mundësinë për të jetuar më mirë nga çfarë është sot. I dyfishoi rrogën dhe kishte një figurë artistike që vlerësohej", -tha zj.Bulku për emisionin "Arkapia"



BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK



RREGULLORJA/ Sot, afati i fundit, eksperiencia në këtë institucion zgjat deri në 6 muaj



Voltiza Duro

Bashkia e Tiranës, studentët mund të aplikojnë për praktikë mësimore

Kriteret dhe dokumentacioni që nevojitet

Të gjithë studentët që vazhdojnë arsimin e lartë e dëshirojnë të kryejnë praktikën mësimore në Bashkinë e Tiranës, kanë mundësi edhe sot për të aplikuar. Ky njoftim është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë ku bëhen me dije kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për tu shpallur fitues. Kështu, të interesuarit duhet të jenë duke ndjekur studimet e larta brenda ose jashtë vendit, të mos jenë dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jenë në ndjekje penale. Ndërkaq Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore në këtë institucion thekson se datat e aplikimit për kryerjen e praktikës mësimore janë: 03-31 janar për praktikantët që do të zhvillohen gjatë 6 muajve të parë të vitit (periudha shkurt-qershor) dhe 01-30 prill për praktikantët që do të zhvillohen gjatë 6 muajve të dytë të vitit (periudha korrik-dhjetor).

DOKUMENTACIONI

Pra, brenda ditës së sote, studentët e arsimit të lartë në nivelin bachelor apo master mund të kryejnë aplikimin online nëpërmjet plotësimit të formularit. Aplikantët duhet të dorëzojnë një curriculum vitae (CV), fotokopjen e mjetit të identifikimit, një vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë që tregon se praktikanti është duke vazhduar studimet si dhe një dëshmi penaliteti. "Praktika mësimore në Bashki zhvillohet sipas profilin të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e staffit akademik të caktuar nga departamenti përkatës i institucionit të arsimit të lartë, i cili mban lidhje me Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore gjatë kryerjes së praktikës mësimore nga praktikanti/ grupi i praktikantëve", citohet në rregulloren e praktikave mësimore të firmosur nga kryebashkiaku Erion Veliaj. Më tej, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore shqyrton të gjitha kërkesat dhe dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët e përgatit listën e fituesve, të cilët plotësojnë kriteret e paracaktuara. Në rastet kur numri i është më i madh se kuotat e pranimit në një njësi organizative të caktuar, praktikantit/ grupit të praktikantëve i propozohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore mundësia e kryerjes së praktikës në institucionet e varësishë së Bashkisë, pas marrjes së miratimit paraprak nga këto institucione. Kandidatët fitues do të njoftohen elektronikisht brenda 30 ditëve nga data e fundit e afatit të



Faksimile e vendimit mbi rregulloren e praktikave mësimore

Foto ilustruese

- DOKUMENTACIONI**
- a) Curriculum Vitae;
 - b) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
 - c) Vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë, ku praktikanti është duke vazhduar studimet duke specifikuar vitin e studimit;
 - ç) Dëshmi penaliteti / formulari vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore

KUSHTET

Për t'u shpallur fitues, të interesuarit duhet të jenë duke ndjekur studimet e larta brenda ose jashtë vendit, të mos jenë dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jenë në ndjekje penale.

aplikimit të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës. Në përfundim të praktikës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë plotëson formularin e vlerësimit për praktikantët, dorëzohet

pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, që administron dokumentacionin mbi praktikën mësimore të praktikantit. Më tej, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve

Njerëzore pajis praktikantin me vërtetimin në përfundim të praktikës mësimore e ndërkohë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, me kërkesë të praktikantit plotëson edhe dokumentin e paraqitur nga

vetë praktikanti, në rast se kjo kërkohet nga institucioni i arsimit të lartë ku ai studion. Në çdo rast, pajisja e praktikantëve me vërtetimin përkatës, bëhet pasi ata të kenë dorëzuar pranë

Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore formularin e vlerësimit. Por praktika mësimore edhe mund të ndërpritet në rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore ka konstatuar shkelje të detyrimeve të përcaktuara nga ana e praktikantëve.

"Ligji i arsimit të lartë, avangardë për projektet"

Nikolla: Nuk ka asnjë qindarkë të rritur për tarifat e studimit

Pas akuzave e protestës së studentëve për tarifat e larta, ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla ka mohuar një fakt të tillë. Nga ambientet e Universitetit të Vlorës ajo theksoi se akuzat ndaj ligjit të ri të arsimit të lartë janë të pavërteta. "Në vitin 2015, 2016, 2017 janë po të njëjtat tarifa si në 2014-ën, pra nuk ka asnjë qindarkë të rritur në tarifat e studimit në të gjitha pro-

gramet e studimit, dhe këtu kam parasysh të gjitha universitetet publike në vend", u shpreh ministrja. Kjo e fundit nënvizoi se sipas ligjit të ri të arsimit të lartë, universitetet publike do të jenë në avangardë për të gjitha projektet dhe politikat duke mundësuar jo vetëm atë që universitetet duhet të ofrojnë për komunitetin, vendin, shoqërinë, por edhe duke qënë përfitues të drejtpërdrejtë nëpërmjet di-

versifikimit të mundësive të financimit. "Në vitin 2018-të, do të mundësohet biblioteka dixhitale të aksesueshme së pari, për profesorët e profesorët e nderuar, por edhe për çdo student. Qeveria shqiptare e ka marrë përsipër që pedagogët e studentët të jenë të aksesueshëm në literaturën më bashkëkohore. Gjithashtu, nëpërmjet një buxheti të përcaktuar nga qeveria, do të mundësojmë ofrimin e



Ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla në Universitetin e Vlorës

kurseve të gjuhës angleze falas për studentët por edhe për të rinjtë e tjerë të intere-

suar", - tha ministrja Nikolla nga ambientet e Universitetit të Vlorës.

ISHP

Ka arritur në 45 numri i fëmijëve të konfirmuar me fruth brenda 1 muaji, ndërkohë që mjekët po vazhdojnë të kryejnë vaksinimin e kategorive më të riskuara nga sëmundja. Ndërkohë shumica e vogëlushëve të prekur janë poshtë moshës 1 vjeçare, e gjendja e të sëmurëve nuk paraqitet e rënduar, me komplikacione apo me rrezik për jetën. Gjithash-



Foto ilustruese

Shkon në 45 numri i të prekurve nga fruthi

tu, ISHP bën me dije se nga virusi janë prekur edhe 5 të rritur të lindur në vitet 1980-1990. Vaksina MMR po aplikohet jo vetëm të kategoritë më të riskuara, por edhe në mënyrë të përshtatshme të grupmoshat 9-12 muaj. ISHP thekson se pas alarmit, prindërit janë

ndërgjegjësuar e po i drejtohen qendrave shëndetësore për të vaksinuar fëmijët. Ndërkaq, fëmijët e prekur nga virusi ngjites janë vendosur në një karantinë apo pavion të veçantë në Pediatrinë Infektive në QSUT, ku janë 6 dhoma në katin e dytë për trajtimin e tyre. Gjith-

ashtu, specialistët bëjnë thirrje që pjesa e pavaksinuar të shkojë sa më shpejt të aplikojë MMR pasi ka fëmijë që nuk vaksinohen për arsye shëndetësore dhe nëse ky fëmijë bie në kontakt me një tjetër që nuk është vaksinuar, sepse prindi ka refuzuar, rrezikon jetën. Kështu që duhet të vaksinohen të gjithë për të mbrojtur ata që realisht nuk e bëjnë dot vaksinën e kanë imunodeficiencë.

VITI KULTOR SHQIPËRI-AUSTRI

Nga prof. Paskal Milo*

(Vijon nga numri i djeshëm)

IV. PROFILE PRO DHE KUNDËR AUSTRO-HUNGARISË

Me të drejtë është konstatuar jo vetëm në atë kohë por edhe më vonë, veçanërisht nga studiuesit se shumica e shqiptarëve hyrjen e ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri e përjetuan me një ndjenjë lehtësimi, si çlirim e jo si pushtim. Argumentet në favor të këtij vlerësimi janë disa. Perandoria e Habsburgëve ishte kujdesur për të drejtat e popullsisë katolike në Shqipërinë e Veriut për disa dhjetëra vjet gjatë sundimit osman. Ajo ishte shfaqur si mbështetëse e vendosur për pavarësinë e Shqipërisë dhe kishte lënë mbresa pozitive të shqiptarët me politikën e saj të frenimit të ekspansionit sllav në territoret shqiptare. Veçanërisht me ndërhyrjen e saj në Shqipëri, ajo kishte larguar ushtritë serbe dhe malazeze, që kishin pushtuar territore të gjëra shqiptare nga Shkodra në Durrës, Elbasan, etj.

Ky ishte opinioni i përgjithshëm si një rezultante e perceptimit historik të rolit të Austro-Hungarisë në Shqipëri, por edhe si një përputhje interesash shqiptaro-austro-hungareze gjatë luftës. Në përpunimin dhe ushqimin e këtij opinioni ndikojnë shumë zërat e fuqishëm, potencialet politike, intelektuale, lend lordët lokalë, bajraktarët dhe ata që njiheshin si "zotët e luftës" e që u dëgjohej fjala në kuvend e në popull. Të tillë njerëz nuk i mungonin Shqipërisë brenda dhe jashtë saj.

Vjena ishte kujdesur ndër vite që ta inventarizonte në skedarët e Ballplatz-it këtë pasuri të larmishme njerëzore shqiptare dhe ta vinte sipas rasteve në shërbim të saj. Diplomati të rangut të lartë si Alfred Rappaport apo dhe njohës të thellë të gjuhës, traditave, njerëzve, të mjedisit shqiptar si Lejhanec, August Kral, Buçberger e të tjerë ishin arkiva të gjalla të çështjeve shqiptare. Pastaj kishte një numër jo të vogël shqiptarësh që të shkolluar e të edukuar në Austri, për nostalgji e respekt, por të tjerë edhe për interesa personale, ishin burim informacioni dhe përfaqësues jo zyrtarë të Vjenës e të objektivave të saj në Shqipëri. Modeli më tipik i tyre ishin atë e bir, Syrja dhe Eqrem bej Vlora.

Në galerinë shqiptare të personaliteteve klasifikimi dhe renditja nuk ishte njëherë e mirë e bërë. Në kohë e për konjunktura e interesa të veçanta ato ndryshoheshin për shkak të sjelljes së personazheve, të devijimit të qëndrimeve e të aleancave, mosmarrëveshjeve e pakënaqësive, madje edhe të xhelozive dhe intrigave. Mbështetur në dokumentacionin arkivor austro-hungarez, shqiptar por edhe të disa vendeve të tjera, kjo kategori njerëzish të rëndësishëm të botës shqiptare mund të ndahet në disa grupe sipas kontributeve kombëtare, qëndrueshmërisë në orientim dhe shkallës së angazhimit politik, krahimor e personal e në grupin e kundërshtarëve të vendosur. Ky lloj grupimi është një lloj përpjekje modeste e relative e nuk

PASKAL MILO:

Kur Ismail Qemali e Noli u akuzuan si agjentë austriakë



Në foto: Prof. Paskal Milo

pretendon saktësi absolute.

Edhe njëherë pa vënë në dyshim në përgjithësi motivin e interesit kombëtar në marrëdhëniet me Austro-Hungarinë në vitet e luftës të shumicës së personaliteteve shqiptare, klasifikimi mund të ishte ky: Në grupin e

njerëzve të përkushtuar do të hyjnë Luigj Gurakuqi, Vlorajt atë e bir, Aqif Pashë Elbasani, Fejzi Alizoti, etj. Disa prej tyre ishin edhe nënshkrues të proklamitës drejtuar shqiptarëve në 28 janar 1916 në të cilën bëhej thirrje që ushtarakët austro-hungarezë të priteshin "si


"Syrja dhe Eqrem bej Vlora mendonin për interesat shqiptare, ndërsa Kristo Dako, Sevasti e Parashqevi Qirjazi raportnin kundër Nolit"

shpëtimtarë, jo vetëm me iu bind, por edhe me iu shërbye". Në mesin e tyre pati edhe diferenca për statusin e Shqipërisë nën Austro-Hungarinë. Fejzi Alizoti ishte i bindur se "një Shqipëri e pavarur, nuk do të ishte e aftë të rronte dhe do të ishte mirë që vendi t'i aneksohej Austro-Hungarisë". Syrja dhe Eqrem bej Vlora nuk shkonin kaq larg, por ishin që Shqipëria "të bëhet një shtet i pavarur nën dashamirësinë e lartë të Austro-Hungarisë".

Një grup personalitetesh si Ismail Qemali, Fan S. Noli etj., në vitet e Luftës së Parë Botërore i kanë ndryshuar qëndrimet ndaj palëve ndërluftuese sipas konjunkturave të krijuara, por gjithnjë duke gjykuar në të mirë të interesit kombëtar. Ismail Qemali dhe Fan S.Noli ishin tepër të pavarur

me gjithë varfërinë e tyre për të shërbyer kundrejt shpërblimeve apo favoreve. Nëse në vitet 1912-1913 Ismail Qemali kishte marrë mbështetje nga Vjena dhe kishte bashkëpunuar me ministrin e jashtëm të saj, Berthold, hijet e dyshimit të vetë Ballplatz-it e ndoqën atë nga pas në të dy kahjet: austro-hungarezët dyshonin se ai bënte lojë e italianëve e të Antantës, ndërkohë që kundërshtarët e tij të brendshëm dhe qarqet politike italiane e franceze (San Xhuliano, Sonino, Salandra, Puankare, etj.) e akuzonin se ishte në shërbim të austro-hungarezëve.

Ismail Qemali si shtetar e diplomat me përvojë bënte takime e bisedime me qarqet politike e diplomatike të palëve ndërluftuese evropiane dhe nxir-



Në foto: Ismail Qemali

Në të mirë të interesit kombëtar, Ismail Qemali ndryshoi qëndrim ndaj Austro-Hungarisë ndaj nuk gjeti më mikpritjen e njohur në Vjenë, derisa i thanë je i padëshiruar...



Në foto: Fan S.Noli

I.Qemali dhe Fan S.Noli ishin tepër të pavarur me gjithë varfërinë e tyre për të shërbyer kundrejt shpërblimeve apo favoreve. Doli kundër Austrisë ndaj ndiqej nga shërbimet sekrete amerikane në të gjitha lëvizjet e tij...

← rre përfundime për fatin e Luftës e fundin e saj, gjithnjë me shqetësimin për mbijetesën e Shqipërisë së pavarur. Në Vjenë nuk ia pëlqyen këtë qëndrim sepse mesa duket u ngatërronte letrat në negociatat e fshehta që Berhtoldi po zhvillonte me San Xhulianon për të tërhequr Italinë në Luftë në anën e Boshtit Qendror. Në qendër të këtyre negociatave ishte fati i Shqipërisë, copëtimi i saj si mall këmbimi për të krijuar aleancat. Pikërisht në kulmin e këtyre negociatave, në janar 1915, Ismail Qemali nuk gjeti më mikpritjen e njohur por u sugjerua se "në situatën politike të sotme nuk shihet oportunitet... një qëndrim më i gjatë i tij në Vjenë". Në vijim autoritetet austriake e trajtuan me mospërfillje me justifikimin se "ka shkuar në shtete armiq". Deri në fund të luftës ato nuk e ndihmuar themelesin e shtetit shqiptar të pavarur. Ministri i fundit i Jashtëm i Perandorisë, Buriani e cilësoi atë në verën e 1918 si "një element sa të mërzitshëm aq edhe të padobishëm".

Një personalitet tjetër që mori ngarkesa negative për qëndrimin pozitiv që mbajti ndaj Austro-Hungarisë ishte Fan S. Noli. Në janar 1916, ai edhe në cilësinë e kryetarit të organizatës atdhetare shqiptare "Vatra" në Shtetet e Bashkuara mirëpriti hyrjen e forcave austro-hungareze në Shkodër, por

Te njerëzit e
përkushtuar hynin
Luigj Gurakuqi,
Vlorajt at e bir, Aqif
Pashë Elbasani, Fejzi
Alizoti, etj. Kishin
nënshkruar
proklamaten ku
thuhej që ushtarakët
austro-hungarezë të
priteshin
"si shpëtimtarë..."

raportonte zyrës së shërbimeve sekrete në Boston në qershor 1918 se "Fan Noli dhe klika e tij janë me Austrinë kundër Italisë dhe indirekt kundër Shteteve të Bashkuara për çështjen shqiptare".

Pas këtyre raportimeve nuk vonuan të vijnë edhe rrjedhojat për Nolin. Ai ndiqej nga shërbimet sekrete amerikane në të gjitha lëvizjet e tij, madje edhe kur u ftua me rastin e festës kombëtare në 4 korrik 1918 ku u takua edhe me Presidentin Uilson. Akuzat e Trin-

vinte "në rrezik situatën që qëndronte në themel të marrëveshjes së dy fuqive të Adriatikut". Kur Princ Vidi refuzoi, Hasan Prishtina veprroi në klandestinitet e në bashkëpunim me përfaqësuesit e Vjenës në Shqipëri. Në nëntor 1914 ai u paraqiti përsëri autoriteteve austro-hungareze projektin e tij për organizimin e veprimeve luftarakë në Kosovë kundër forcave serbe.

Këtë herë Vjena në parim e mbështeti projektin dhe udhëzoi konsullin e saj në Shkodër Halla që të bashkonte elementet më me influencë në Shqipërinë e Veriut e në Kosovë kundër Serbisë. Konsulli arriti që të bënte bashkë në Shkodër Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Ahmet bej Matin e në perspektivë edhe Isa Boletinin e Riza bej Gjakovën por sugjeronte se organizimi i një kryengritjeje në Kosovë kundër Serbisë kërkonte financimin tyre "për të blerë municione e për të shpërblyer njerëzit që u shkonin nga pas". Në çështjen e financimeve Vjena u tregua e shtrenguar, por as edhe inkurajoi veprime të shpejta organizative në terren me pretendimin se nuk kishin ardhur ende momenti i duhur që shqiptarët të hidheshin në aksion kundër serbëve.

Kur ushtria austro-hungareze i theu keq forcat serbe në frontin e luftimeve në nëntor 1915 dhe ushtria serbe u tërhoq në panik e me

Kristo Dako, Sevasti
e Parashqevi Qirjazi i
raportuan zyrës së
shërbimeve sekrete në
Boston në qershor
1918 se, "Fan Noli
dhe klika e tij janë me
Austrinë kundër
Italisë dhe indirekt
kundër Shteteve të
Bashkuara për
çështjen shqiptare."

me austro-hungarezët aq edhe me serbët e bullgarët. Vjena i joshi me para dhe me grada për t'i përdorur e për të mos i pasur kundër: Kur e tepruan në pabesinë e tyre, i mori dhe i internoi deri në përfundim të luftës si Basri bej Dukagjinit dhe Preng Bibë Dodën në territoret dalmatine të perandorisë.

Më të riun Ahmet bej Mati u soll disa më ndryshe për ta pasur nën kontroll e për ta përdorur. Beu i Burgajetit kishte disa cilësi prijësi, ishte i shkathët e i mprehtë, ish-

U gjend një zgjidhje tjetër, më e rafinuar për ta neutralizuar. Në prill 1917 ai u përfshi në një delegacion të gjerë të parisë shqiptare, që u ftua në Vjenë për të marrë pjesë në ceremoninë e kurorëzimit të Karlit I si perandor i ri. Zogut i kushtuan një vëmendje të veçantë. E dekoruan me Kryqin e Komandantit të Urdhrit të Franc Jozefit I. Por kur anëtarët e tjerë të delegacionit u nisën për t'u kthyer në Shqipëri atë nuk e lejuan, por e mbajtën në Vjenë. Nuk ishte internim sepse ata që konsideroheshin të rrezikshëm nuk i dërgonin në kryeqytetin e perandorisë. Aty u mbajt deri në përfundim të luftës duke vepruar siç pohonte një burim zyrtar "me zell në interesin tonë".


Në të njëjtën kohë me Ahmet Zogun në Vjenë qëndronte edhe Faik Konica. Të dy, siç edhe ka shkruar beu erudit i Konicës me beun e ri të Matit kanë shijuar koncertet dhe operat në Operën e famshme të Vjenës. Veç qasjet ndaj Perandorisë i kishin të ndryshme. Faiku ishte kritik ndaj politikës austro-hungareze në Shqipëri. Vetri ai në fund të Luftës i pohonte Obri Herbertit (Aubry Herbert) se "për tre vjet kam qenë një i burgosur shoqëror (konfiniert) në Austri, sepse kam kritikuar hapur qeverisjen e keqe austriake në Shqipëri".

Konica në Austri bënte një veprimtarë intensive për zgjedhjen pas lufte në Shqipëri të një princi turk. Ishte nga ato kthesa e trille që vetëm ai mund t'i bënte e pa të cilat ai nuk kuptohej. Mirëpo për shkak të kësaj propagande autoritetet austro-hungareze e mbanin nën vëzhgim, madje i kishin kontrolluar edhe shtëpinë. Ndaj edhe Faiku shfryn se "...në Shqipëri austriake nuk u ka mbetur më ndonjë mik..." dhe se "edhe vetë katolikët janë tani kundër Austrisë".

Mlefi i Konicës është më tepër reaktiv, emocional se sa racional. Megjithatë, nuk ka dyshim se ka pasur edhe pakënaqësi, sepse jo gjithçka që austro-hungarezët premtuan u bë në Shqipëri. Lufta kishte rrjedhoja negative për popullsinë e varfër, kishte privime, uri, sëmundje të rënda epidemike që autoritetet ushtarake austro-hungareze nuk arritën t'i përballojnë e ti zgjidhin. Jo gjithçka edhe për faj të tyre. Në disa raste u krijuan edhe armiqësi me shqiptarët për shkak të disa veprimeve ekstreme të segmenteve të veçanta ushtarake, siç ishte vrasja e 44 shqiptarëve të pafajshëm në Lurë për hakmarrje apo e tre nënoficerëve shqiptarë në Fier.

Kjo retrospektivë e shkurtër e marrëdhënieve shqiptaro-austro-hungareze në Luftën e Parë Botërore përcjell sot një mesazh: historia duhet shkruar në kompleksitetin e në vërtetësinë e saj, jo në dimensionin bardhë e zi, atdhetarë e tradhtarë, heronj të pakontestuar e armiq historikë e të përjetshëm. Duhet pastruar jo vetëm historia nga të pavërtetat, por edhe mendjet e infektuara të njerëzve prej tyre, sidomos e të rinjve që bien viktima të shtrembërimeve të qëllimshme të ngjarjeve e të fakteve historike nga arrivistët politikë e pseudonacionalistët. Të mbjellim e të kultivojmë respekt jo vetëm për vlerat tona, por edhe për ato të tjerëve. Nuk duhet të mbe-temi pengje të së kaluarës ndryshe nuk shohim rrugën e të ardhmes.

(Titujt janë të redaksisë)



Në foto:
Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi,
Faik Konica dhe Ahmet Zogu



kërkoj edhe ngritjen e flamurit shqiptar.

Qëndrimi i Nolit dhe i "Vatrës", i bërë i njohur përmes gazetës "Dielli" u vu re nga diplomatët austriakë në Uashington e përmes tyre edhe në Vjenë. Këtyrë qëndrimi në mars 1916 u përgjigj ambasada austriake në Uashington, por edhe ministri i Jashtëm Buriani. Zyrtarisht ata i shkruan gazetës "Dielli" se flamuri i Shqipërisë valon bashkë me flamurin e Austro-Hungarisë në të gjitha zyrat e administratës vendore në Shkodër. Ky veprim u përshëndet nga Noli, i cili shkroi në "Dielli" se Austria "e njeh shtetin shqiptar dhe flamurin tonë si përpara luftës evropiane".

Me hyrjen e SHBA në Luftë në prill 1917 Noli ndryshon qëndrim. Por kjo nuk e shpëtoi Nolin nga akuzat e kundërshtarëve të tij shqiptarë, sidomos ato të Trinisë (Kristo Dako, Sevasti e Parashqevi Qirjazi), të cilët u futën në lidhje të fshehta me departamentin e drejtësisë dhe shërbimet inteligjente amerikane duke e cilësuar atë si proaustriak. Akuzat ishin se Noli mbështetej nga qeveria austriake, se ai ishte dërguar prej saj me mision në Amerikë që të punonte me shqiptarët aty në interes të Fuqive Qendrore. Dako i

"Nga Luigj Gurakuqi të Faik Konica, Ahmet Zogu e Hasan Prishtina - personalitetet që u mpleksën me Austro-Hungarinë"

isë Dako-Qiriazit për Nolin krijuan një dosje dyshimi për të në administratën amerikane që do t'i rëndojë për shumë vite atij dhe që rrjedhojë të parë pati pengimin e tij për të shkuar në Konferencën e Paqes në Paris (1919-1920) në përfundim të Luftës së Parë Botërore.

Grupi tjetër i njohur që bashkëpunoi me Austro-Hungarinë ishte ai i shqiptarëve të Kosovës me në krye Hasan Prishtinën. Për vetë origjinën e tyre ata ishin kundërshtarët më të vendosur të Serbisë. Kur Austro-Hungaria i shpalli luftë Serbisë në 28 korrik 1914, Hasan Prishtina si anëtar i qeverisë së Princ Vidi propozoi organizimin e forcave shqiptare nga Shqipëria e Kosova për të hapur front lufte kundër Serbisë. Vjena, e cila ishte ende në bashkëpunim me Romën për çështjen shqiptare nuk e mbështeti në parim këtë propozim me arsyetimin se "shkelja e asnjësisë së Shqipërisë ishte në kundërshtim me vendimet e Londrës" dhe

humbje shumë të rënda përmes Shqipërisë, nevoja për organizimin e një kryengritjeje në Kosovë ra. Për rrjedhojë edhe roli i eksponentëve shqiptarë në sytë e Vjenës, u minimizua por ata u mbajtën afër me gjithë pakënaqësitë e dyshimet e ndërshjella. Gjithashtu, autoritetet ushtarake austro-hungareze ndaluan edhe përpjekje të qarqeve nacionaliste për të mbledhur një kongres kombëtar në Elbasan në mars 1916 për organizimin e vetëqeverisjes së vendit deri në kohën e rikthimit të Princ Vidi. Po kështu kundërshtuan dhe eliminuan lëvizje separatiste dhe aventureske të tipit të Basri bej Dukagjinit.

Një grupim tjetër prijësish krahinorë dhe me ambicie të mëdha për të qeverisur gjithë Shqipërinë ishin Preng Bibë Doda, Ahmet bej Mati, myslimani bullgar Hasan (alias Basri) bej Dukagjini, etj. Këta i luanin të gjitha kartat për të nxjerrë përfitimet e momentit, sa

Opinion i Ditës

Sekreti i marrëveshjes së detit

Nga Dritan Hila

(Vijon nga faqja e parë)

... ndodh që si tifozët ashtu edhe cheerleaders (udhëheqësit e tifozëve në futbollin amerikan), nuk dinë shumë gjëra.

Madje iu mjafton zjarri i partisë se nuk dinë fare. Dhe kjo është sëmundje dypalëshe.

Ishte simpatik momenti gjatë dëgjësës në komision të ministrat Bushati, i cili nuk shpjegoi asgjë, kur një vajzë deputete e PS, në stilin Laje, lavdëroi punën e lavdërueshme të tij dhe fitoi kolegët e opozitës t'i bashkoheshin.

Ndërkohë opozita vazhdon vijën politike se Berisha nuk gaboi, por nuk e kuptoi populli, dhe ka dy linja ku njëra thotë se socialistët shpesh më shumë sesa dha Berisha, dhe linja tjetër që pretendon se jo vetëm shpesh, por humbën 5 vjet në marrëdhëniet dy palëshe.

Këtyre iu është përgjigjur Rama me stilin e zakonshëm provokativ, i cili i ka satirizuar, duke iu thënë se duhet të presin dhe do të turpërohen.

Por, le të përpiqemi të bëjmë një analizë. E gjithë furtuna nis nga deklaratat e Kotzias në televizionin grek ERT se Shqipëria njohu të drejtën e Greqisë për 12 milje ujëra territoriale.

Ky është një veprim normal i Shqipërisë nëse do të futet në BE dhe mbi të gjitha si nënshkruese e konventës së UNCLOS apo e njohur me emrin e vend nënshkrim-it, Konventa e Montegobay.

Por errësira që po mbulon bisedimet nuk sqaron nëse edhe Greqia ka njohur këtë të drejtë tonë për 12 milje ujëra territoriale?

Deri këtu nuk ka shifje territori, por e shumta mungesë reciprociteti nëse edhe grekët nuk kanë njohur të drejtën tonë për 12 milje ujëra territoriale.

Por le të kthehemi në marrëveshjen e shkuar detare. Gjithë problematika e saj ishte vija ndarëse aty ku ujërat që ndajnë tokën shqiptare nga ajo greke është më pak se 24 milje. Në këtë rast bëhet fjalë për ngushticën e kanalit të Korfuzit.

Gafa e palës shqiptare në këtë pikë qëndron në faktin se shfuqizoi ligjin e vitit 1976 që e njëjtte Gjirin e Sarandës si gjë të brendshme, dhe kështu vija bazë e territorit shqiptar nuk kalonte në segmentin që bashkon ekstremet e gjirit



të Sarandës, por në vijën e bregdetin shqiptar. Problemi që vazhdon dhe mbetet, është se qeveria Rama ende nuk ka bërë një ligj që e ripërkufizon Gjirin e Sarandës si ujëra të brendshme. Dhe kjo shkakton probleme në negociimin e ardhshëm dhe ngre dyshime. A e ka njohur pala greke si ujëra të brendshme shqiptare këtë gjë? Në të shkuarën vetëm për këtë pakujdesi ne humbitim 34 km².

Pika e dytë dhe më problematike lidhet me faktin sesi do të konsiderohej ishulli i pabanuar Barketa si territor mbi të cilin do kalonte vija bazë? Në marrëveshjen e sh-

kuar u konsiderua si e tillë, pavarësisht se mënyra e interpretimit është e ndryshme. Gjithsesi mbetet për t'u parë sesi do të silllet të ardhmen pala shqiptare për ato pika ku dy brigjet respektive janë më pak se 24 milje nga njëri-tjetri.

Deri tani me njohjen e të drejtës greke për ujëra territoriale deri në 12 milje, Shqipëria nuk ka bërë ndonjë hap që e kompromenton. Kjo njohje mund të ketë probleme si precedent në marrëdhëniet turko-greke, të cilat kanë probleme me vijën detare ku pala turke nuk i njeh më shumë se 6 milje fqinjëve të saj, dhe njohja shqiptare nuk

besoj t'i ketë ardhur për mbarë. Por kjo është temë e gjërë. Por lidhur me marrëveshjen aq të përfolur; dhe të hedhur pushtë nga Gjykata Kushtetuese, Ministria e Jashtme nuk ka kompetenca ta rinegojë pasi ajo është e vdekur. Ka të drejtë vetëm të fillojë një negociim të ri, por për këtë i duhen mandatet e caktuara ligjore, të cilat nuk i ka. Ndjaj ende nuk ka nevojë për panik. Deri tani bëhet fjalë për ujëra që nuk na takojnë. Por edhe errësira informative duhet të marrë fund një orë e më parë, pasi edhe kështu ka mjaft tension.

/dritare.net

HOROSKOPI

DASHI

Një e fshehtë sot, një fshehtë nesër, rrezikoni të mos mbarë më mend se cila është kështjella e fantazisë që keni ndërtuar. Më mirë të ktheheni në realitet! Nëse keni në mendje në lidhje nga e kaluara, mos u angazhoni për të ardhmen.

DEMI

Këshillohet të përballemi çështje të pazgjdhura në fushën e dashurisë. Duhet t'i shqyrtoni gjërat nga çdo këndvështrim, pa u fshehur pas iluzioneve. Nëse një epror ju kërkon të punoni përtej kompetencave të juaja, qëndroni të qetë dhe refuzoni.

BINJAKET

Humori do t'ju ndryshojë dhe nuk do t'ia dini të shfrytëzoni mundësitë që do të keni gjatë ditës. Mirëkuptimi me partnerin do të jetë i pakët. Përqendrohuni në përbushjen e objektivave atashkurtra, edhe pse bëni zgjedhje largpamëse.

GAFORJA

Ditën e sotme do të kuptoni se nga kanë ardhur disa tensione ekzistuese në shtëpi si edhe do t'ju jepet mundësia t'i zgjidhni. Do të gjeni zgjidhje të papritura për probleme që ju kanë bërë të ndihni të bllokuar, duke bërë të mirë frymë lirish.

LUANI

Duhet të punoni për të harmonizuar kërkesat e ndryshme, që rrezikojnë të bien ndesh me njëra-tjetrën. Mësoni të dëgjoni më shumë të tjerët. Nëse nuk arrini të gjeni një marrëveshje të kënaqshme, mos u nxitoni: më mirë të ndryshoni vendimin.

VIrgjeresha

Duke vëzhguar, do të zbuloni se jeta në çdo ditë mund t'ju dhurojë ato gjërat e vogla të bukura që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore: jeni shumë të ndjeshëm dhe përfshihen shpejt në gjendjen emocionale të të tjerëve.

PESHORJA

Bëni kujdes nga marrëveshjet e bëra dhe padituria e juaj në situata pak të qarta. Por mos reagoni në mënyrë të tepruar. Me Saturnin që e keni kundra, sot do të ndiheni se jeni pushuar nga mëdyshe që do të bëjnë të jini të paqartë. Por gjërat do të rregullohen.

AKREPI

Pritet që ditën e sotme të keni keqkuptime të mundshme në familje, e për rrjedhojë një ndjenjë fajësie për çdo gjë pa arsye. Klima e ftohtë ju bën të mbylleni në shtëpi, por angazhimi të ndryshme ju shtrëngojnë të jeni në lëvizje. Me durim do t'ia dini.

SHIGJETARI

Bën mirë ta merrni parasysh veprimet e juaja, sepse ndodh që persona që ju rrethojnë mund të shqetësohen për ju. Vazhdoni të angazhoheni për punët profesionale, por lejojini vetes edhe pak kohë të lirë dhe shijoni emocione të ndryshme nga e zakonshmia.

BRICJAPI

Bashkëveprimi i planetëve ju sjell fatin në anën e juaj, dhe mbi të gjitha, do të bëjë që punët të mos ju marrin shumë kohë nga kënaqësia. Në punë parashikohen bashkëpunime të reja, projekte të reja dhe perspektiva të reja më fitimprurëse.

UJORI

Sot nuk është dita për të marrë vendime të nxituara. Para se të veproni, mendohuni mirë! Druajtja se mos dini keq, për fat, do t'ju shpëtojë! Ndikimi i Saturnit do të bëjë që të jeni jo të qetë, jo të saktë dhe të shpërqendruar. Mundohuni të mos ndikoheni.

PESHQIT

Thellohuni në gjërat që ju përshtaten dhe ju interesojnë më shumë, dhe do të rrisni kompetencat tuaja profesionale. Jupiteri ju mbështet dhe do të bashkëpunojë për t'ju ndihmuar të zgjeroni horizontin dhe të paturoni lidhjet me të tjerët.

BalkanWebJ.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion *i* Ditës

Nga Erl Murati

Pakti detar, të besojmë ERT-në apo ERTV-në?

(Vijon nga faqja e parë)

... e plotfuqishmërisë - thënë ndryshe: autorizimit që presidenti i Republikës u jep negociatorëve të qeverisë për të lidhur marrëveshje me shtete të tjera.

Nuk dihet nëse negociatorët e MPJ e kanë marrë këtë dokument nga presidenti Meta, por nëse kanë dështuar ta bëjnë këtë, pakti i ri detar është lehtësisht i rrzueshëm në gjykatë.

Ky detaj në dukje teknik, nuk është e vetmja pikë e errët e marrëveshjes dypalëshe Shqipëri-Greqi.

"Bomba" që plasi Nikos Kotzias në televizionin grek "ERT" kur tha se "Shqipëria pranoi që ne ta shlyjmë kufirin detar në 12 milje" ndeshi në reagime të padeshifrueshme në Tiranë.

Këto reagime, në vend se të bënin transparencë e të davarisnin dyshimet, i shtuan ato.

Sot, është ende e paqartë nëse kemi apo jo një marrëveshje, pra nëse palët kanë rëndë dakord mbi një dokument, janë në fazë negociatash apo ende nuk i kanë nisur ato.

Kryeministri Rama shkroi: "Hesapet e 70 viteve me fqinj, dimë t'i mbyllim me mirëkuptim në interes të shqiptarëve". Pra, kreu i qeverisë nënkuptoi se marrëveshja në mos është mbyllur, po mbyllet dhe pritet vetëm "të shkruhet e zeza mbi të bardhë", siç tha ai.

Por, Ministria e Jashtme bëri një deklaratë të ndryshme.

Ministri Bushati përmendi respektimin e Konventës për të Drejtën e Detit dhe tha shprehimisht: "Ky qëndrim është pika e nisjes për ekspertët që do të negociojnë me palën greke për këtë çështje".

Ditmir Bushati foli në kohën e ardhme "do të negociojmë", Edi Rama tha "dimë t'i mbyllim", greku Kotzias e bëri punë të mbaruar.



Cili i afrohet më shumë të vërtetës nga këto 3 qëndrime?

Tjetër: Edi Rama i etiketoi sot të interesuarit për çështjen "patriotë me çizme dhe çamëristë..."

Zoti më faltë, po unë nuk e imagjinoj dot kryeministrin Cipras që, në përpjekje për të ulur vrrullin nacionalist në Greqi të shkruajë, "patriotë me çizme dhe vorio-epiristë..."

Çamëria është një plagë shumë

e madhe në historinë e Shqipërisë për t'u tallur me të. Çamët janë masakruar ndër vite dhe kanë vuajtur mjaft në të dyja anët e kufirit, ndaj kryeministri i tyre mund t'ua kursejë termin përbuzës "çamëristë".

Në vitin 2009, kur "Gazeta Shqiptare" zbuloi paktin detar, ne shkruam në faqen e parë, me gërma kapitale, të kuqe, titullin: Berisha shet Shqipërinë!

Pesë kolegë të mediave të ndryshme më kanë kërkuar sot numrin e telefonit të Myslim Pashajt. Koloneli u bë personazh publik, pasi bëri ekspertizën teknike të marrëveshjes që i "falte" Greqisë mbi 300 kilometra katrorë territor.

Sot, koloneli nuk mund të flasë sepse nuk kemi një dokument që ai ta shqyrtojë, nuk kemi koordinatat t'i analizojë dhe nuk kemi hartat që t'i dekurtojnë.

Dakordësinë që është arritur për varrezat e ushtarëve grekë, ne e mësuam nga mediat e vendit fqinj. Vendimin për heqjen e ligjit të luftës apo rishikimin e teksteve të historisë, gjithashtu.

Transparencë e qartësi nuk ka dhe shqiptarët për të mësuar të vërtetën janë të detyruar të ndjekin ERT-në greke, ndërkohë që duhet të kishte mjaftuar të ndiqnin ERTV-në shqiptare.

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

Gdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE



Shkak, bluza me logon e UÇK-së

Do firmoste me APOEL-in, tifozëria qipriote hedh në erë bisedimet me Kaçen

Nuk ka qetësi për Ergys Kaçen. Futbollisti i përfaqësueses shqiptare ka parë dje të dështojë një tjetër transferim i tij dhe mundësia për të luajtur si titullar në pjesën e mbetur të sezonit në radhët e APOEL në Qipro.

Lojtari do të udhëtonte drejt Qipros për të kryer vizitat mjekësore dhe për të formalizuar huazimin 6-mujor te klubi që mban vendin e dytë në kampionatin e këtij vendi. Por në mënyrë të çuditshme, gjithçka është mbyllur

në mënyrë të turpshme. Tifozëria e klubit të APOEL u është kundërvënë drejtuesve për këtë lëvizje, pasi nuk dëshiron që Kaçe të veshë fanellën e këtij ekipi si pasojë e fotos së famshme me fanellën e UÇK të 4 viteve më parë. Ti-

fozëria e APOEL ia ka bërë të qartë klubit këtë qëndrim dhe ka paralajmëruar protesta, duke detyruar qipriotët të tërhiqen nga kërkesa e tyre për huazimin e Kaçes, pak orë para finalizimit të marrëveshjes. Ndaj lojtari ka mbetur në Greqi, në pritje të një telefonate të një klubi tjetër, që dëshiron ta transferojë nga PAOK, ndërsa "VIP Sport" ka mësuar se dy opsionet më të mundshme të tij në janar janë Panathinakos dhe PAS Janina.

Talenti i Lacios vjen pas ndërmjetësimit të Tares. Duhej të shkonte në Korçë, por...



Jeton Selimi

Nuk përmbahet Flamurtari, i merr sulmuesin Skënderbeut

Korçarët ngushëllohen me Realdo Filin

Flamurtari nuk ka të ndalur. Vetëm pak orë para mbylljes së merkatos, drejtuesit vlonjatë kanë realizuar goditjen e "çmendur", duke siguruar shërbimet e sulmuesit senegalez të Lacios, Mamadou Tounkara. 22-vjeçari është goditja më e bujshme në këtë merkato dimri për Kategorinë Superiore. Ai u përfol në fillim se mund të transferohej te Skënderbeu, por marrëdhënia e mirë e administratorit Sinan Idrizi me drejtorin sportiv të Lacios, Igli Tare kanë bërë të mundur që sulmuesi të arrijë akordin me vlonjatët. Lajmi është konfirmuar edhe nga vetë Idrizi për "Panorama Sport" dhe shumë shpejt pritet që senegalezi t'u bashkohet kuzezinjve në formë huazimi deri në fund të sezonit. Tounkara ka qenë pjesë e akademisë së Barcelonës, ndërsa në vitin 2012 kaloi tek ekipi i moshave të Lacios, ku u



aktivizua edhe 2 takime me skuadrën e parë. Më pas ai u huazua te Krotone në Serinë B, ku u aktivizua në 7 takime dhe realizoi 1 gol, ndërsa së fundmi, 22-vjeçari ishte pjesë e Salernitanës. Me afrimin e senegalezit, trajneri Duro do të ketë një sulm luksi, pasi kujtojmë që në dispozicion të vlonjatëve

për këtë repart janë lojtarë kualitativë si Muarem Muarem, Bushiç, Danilo Alvesh, Nedeljković, Sedu Kamara dhe Ardit Hoxhaj. **FILI** Pak orë pasi ka fituar "lirinë" nga detyrimet kontraktuale me Partizanin, Realdo Fili ka filluar bisedimet me klube të ndryshme të Supe-

riorës dhe është shumë pranë një marrëveshjeje, që do të ishte e bujshme për mënyrën se si rrodhën ngjarjet. Fili ka nisur bisedimet me klubin e Skënderbeut dhe është shumë pranë marrëveshjes me skuadrën korçare, duke ndjekur të njëjtën rrugë që ka bërë disa javë më parë edhe Emiliano

Vila, ilarguar nga Partizani. "VIP Sport" ka mësuar se gjatë orëve të fundit ka pasur bisedime të shumta mes palëve dhe marrëveshja është drejt finalizimit, pasi po diskutohen detajet e kohëzgjatjes së kontratës së sulmuesit të talentuar. Nëse gjithçka do të mbyllet me sukses, Fili do të ishte një alternativë më shumë për trajnerin Daja në fazën ofensive. Gjatë fundjavës, Skënderbeu shfaqti probleme të theksuara në fazën sulmuese, pikërisht për shkak të mungesave në repartin e avancuar dhe Daja u detyrua të improvizonte Vilën si sulmues krahu. Me afrimin e Filit, për teknikun e korçarëve do të kishte një problem më pak për të zgjidhur në një moment kur dëmtimet kanë reduktuar ndjeshëm alternativat e lojtarëve që ka në dispozicion.

SULMUESI



Klop i mbyllt derën, Obamejang drejt Arsenalit

Megjithëse ende asgjë nuk është zyrtare, Arsenal duket se po bën goditjen në orë të fundit të merkatos së janarit. Bëhet fjalë për sulmuesin Pierre-Emerick Aubameyang, i cili dje ka lënë aeroportin e Dortmundit dhe është nisur drejt Londrës. Sipas asaj që raporton gazeta angleze "The Sun", ky operacion i ka kushtuar Arsenalit 55 milionë paund, duke siguruar një pagë prej 180 mijë paund në javë në Londër. Lajmi është prituri mirë nga tifozët e "topçinjve", të cilët kanë nisur të personalizojnë edhe bluzat e para me mbemrin e sulmuesit, të cilit i kanë vënë dhe numrin 14, i cili më parë është mbajtur nga legjenda Thierry Henry. Obamejang është pjesë e Borussia Dortmund që nga viti 2013, duke u bërë menjëherë një titullar fikse në radhët e kësaj skuadre. Por, problemet jashtë fushës së lojës dhe çështjet disiplinore zbehën lidhjen e tij me klubin, duke kërkuar tashmë fillimin e një aventure të re larg Gjermanisë. Sulmuesi mendohej se do të përfundonte te Liverpool, por trajneri Jurgen Klop e cilësoi të panevojshëm afrimin e tij, duke i hapur rrugë transferimit të Obamejang tek Arsenalit.

MESFUSHORI

Milot Rashica firmos për Verder Bremenin

Përfliete se kërkohet nga Ajaksi, por mesa duket Milot Rashica ka kryer një lëvizje surprizë. Shqiptari ka kryer vizitat mjekësore te klubi gjerman i Verder Bremenit dhe tashmë zyrtarizimi mbetet vetëm çështje ditësh. Rashica është në kontratë deri në vitin 2020 me klubin e Viteshes dhe mediat spekulojnë se për kartonin e tij, Verderi do të paguajë një shumë të majme, nga 5 deri në 10 milionë euro. Kjo lëvizje mendohet të jetë ndihmuar edhe nga ish-mesfushori i Kombëtares shqiptare, Altin Lala, për të bërë të mundur këtë transferim.

SULMUESI

Levante jep 1 milion euro për Armando Sadikun

Armando Sadiku ka marrë kritika të shumta për apjesën e parë të sezonit të Legia e Varshavës, pasi në kampionat ka gjetur rrugën e rrjetës vetëm dy herë. Janë shpenzuar goxha për kartonin e tij, ndaj edhe pritshmëritë e klubit polak janë të mëdha. Së fundmi për Sadikun ka dalë në skenë një klub spanjoll, Levante, që sipas mediave iberike, është gati të ofrojë rreth 1 milion euro për kartonin e tij. Me siguri te Legia do mendohen mirë, pasi një ofertë e tillë është mjaft e mirë dhe nëse nuk e kanë në planë me të vërtetë, ky është shansi më i mirë për ta për ta shitur. E blenë 750 mijë euro dhe kanë shpenzuar për pagat e tij, por nëse shitet, gjithçka do të shkonte gati "jek e jek".




BRAZILIANI

Nejmar sqaron episodin e penaltisë me Kavanin

Që kur u transferua nga Barcelona te PSG për 222 milionë euro, raportet e tij me Edinson Kavanin nuk kanë qenë të mira, për të mos thënë se janë përkeqësuar ndeshje pas ndeshjeje. Episodi i penaltisë në ndeshjen me Dizionin, ku PSG shënoi 8 gola, solli shumë polemika. "O'Ney" i mohoi penalltinë shokut të skuadrës, i cili nëse shënonte, kalonte Ibrahimovicin në klasifikimin e shënuesve më të mirë të PSG-së. Për herë të parë që nga koha kur ai episod ndodhi, Nejmar ka zbuluar më në fund arsyen pse e gjuajti ai penalltinë, që i mohoi Kavanin golin e rekordit: "Ishte e pamundur të mos e dija për rekordin e tij, por trajneri më ka zgjedhur mua për penalltinë. Nuk ka asnjë problem në këtë rast. Të gjithë në dhomat e zhvieshjes e dinë çfarë ndodh aty, trajneri vendos dhe unë mora topin. Jam shumë i qetë dhe i lumtur me shokët e ekipit dhe miqtë e mi në Paris. Kam ardhur këtu për të shënuar një 'thes' me gola dhe të bëj historinë", - ka thënë Nejmar.



Fjalëkryqi (1)



- 36. Një pjesë e dimensioneve.
- 39. Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- 41. Kalimi në ekstreme.
- 42. Është e re pas Krishtit.
- 43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
- 44. Si i gjithë .
- 47. Kush e thotë lutet.
- 48. Kufij elementi.
- 49. Ishte nja që preu Aleksandri i Madh.
- 50. Një pjesë e titanëve.
- 51. Mund të jetë kundërmuese.
- 52. Pak titanike.

VERTIKAL

- 1. Si i përshtatëshëm.
- 2. Mund të jenë fetare.
- 3. Ai i kuq e ka një huq.
- 4. Pak analogji.
- 6. Është metri i rrobaqepësit.
- 7. Në hyrje të oazit.
- 8. Arte pa re.
- 9. Arthur që qe dramaturg.

HORIZONTAL

- 1. Mund të jetë kursimi.
- 5. Ylli i Nostradamus.
- 8. Tamam pa kufij.
- 11. Ross këngëtare.
- 13. I lashtë.
- 15. Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- 19. Kufijtë e lëvizjes
- 20. I ka tek plepi.
- 21. Paguhen për shërbim.
- 23. Fillojnë lejen.
- 24. Kufizojnë trotualet.
- 25. Bëjnë karrierë në parti.
- 27. Thahet me bonifikim.
- 28. Mund të jetë unik një i tillë .
- 29. Preka komik shkordran.
- 31. Fund dhjetori.
- 32. Fillojnë aksionin.
- 33. Ente Operative Tiranë
- 34. Agjenci Ajrore Durrës.

- 10. Janë boshte.
- 12. Michelangelo regjisor.
- 14. Mund të bëjë stil të lirë .
- 16. Ishin monedhe te Tobias.
- 17. Është bas me katër tela.
- 18. Pak efikasitet.
- 22. Është marrëveshje me nota.
- 25. Ishte babai i Akilit.
- 26. Fillojnë nazet.
- 27. Në krye të kuadrove.
- 29. Është faqe muri.
- 30. Një appendisit i menjëhershëm.
- 35. Kurosawa që qe regjisor.
- 36. Writen nga espada.
- 37. Është shtet aziatik.
- 38. Edouard piktor.
- 40. Një transporti është kamioni.
- 45. Unii i Freud.
- 46. Një cigan.
- 47. Fundi i një samurai.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- 1. Fillojnë panikun.
- 3. Gibson aktor.
- 5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- 9. Mund të jetë trofe.
- 11. Janë vendet si Katar
- 14. Maureen që qe aktore.
- 16. Janë kundërmuese.
- 17. Mund të fitojnë etapa.
- 20. Ushtojnë nga "ola".
- 22. Një thirrje
- 26. Janë ministritë.
- 27. Një rrugë në Paris.
- 28. Markë cigareje.
- 29. Është ngjinja.
- 32. Ricciarelli soprano.
- 33. Fillojnë sefte.
- 34. Ente Ekonomike Sarandë.


VERTIKAL

- 35. Mbyllin një ditar.
- 36. Sateliti i Jupiterit
- 37. I ka tek Luani.
- 38. Boldi komik italian.
- 42. Është kolana në filma
- 43. Kush e thotë lutet.
- 44. Oxa këngëtare.
- 46. Inicialet e Nolte aktor.
- 47. Është tokë që... fitohet.
- 48. Një... gjermane.




- 1. Një votë në favor.
- 2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- 3. Në hyrje makinës.
- 4. Fillojnë lehtë.
- 5. Irlanda në Dublin.
- 6. Është edhe ajo e historisë.
- 7. Një pjesë e gamiljeve
- 8. Notat pa kufij.
- 9. Ishin komitë.
- 10. Ka kryeqytet Islamabad.
- 12. Don... i interpretuar nga Terence
- 13. Mbyllin aktet.
- 15. Janë përmasa.
- 18. Gjysma e lujjes.
- 19. Castellitto aktor.
- 20. Inicilat e Dalí, piktor.
- 21. Tanita këngëtare.
- 23. Është trysni
- 24. Në hyrje të Europës.
- 25. Janë rrobat për t'u larë.
- 30. Bën mëza.
- 31. Moreau aktor.
- 32. Janë thika.
- 39. Një pjesë e satelitit.
- 40. Janë teke në sende.
- 41. Pak marramendëse.
- 42. I ka tek zdapi.
- 45. Inicialet e Nolte-s.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

2	6	9			7		3
		5	8	2	1	6	
4			6				8
1			5				4
8		4				2	6
	9				8		7
	7				5		1
		3	1	4	7	8	
5	1				6	3	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	1	6	2	8	4	3	5	9
2	8	3	9	6	5	1	7	4
4	5	9	3	1	7	6	8	2
3	4	1	6	7	8	9	2	5
6	2	5	1	4	9	8	3	7
9	7	8	5	3	2	4	1	6
1	3	2	7	9	6	5	4	8
5	6	4	8	2	3	7	9	1
8	9	7	4	5	1	2	6	3

Argëtim filozofik

SAMI FRASHERI

- Fjalët dhe punët e njerëzve të mëdhenj nuk janë sipas vendit e kohës së tyre, ata mund t'i përshtaten çdo kohe dhe çdo vendi.
- Njeriu nuk është i përrjetshëm, le të përpqet të jetë e pavdekshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të bëjë.
- Kush bazohet në forcën, bie për tokë po sa të thyhet forca, por ai që bazohet në drejtësinë, është i mbështetur në një godinë të fortë që nuk shembet kurrë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2		7	3		13		2		
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6	
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5		
12	5	13	5	10	1	7		6		13		
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6	
8	2	6	2	2	2	1	8	5	11	1		
1	6	8		17	9	5	7	2		9		
3	1	5		8	2	16			2	7	1	
2			3	2	6	5	9	2		1	13	
6	2	7	2			3		7	18	18	6	7
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2		

S	T	R	I	P	B	B		V	O	T	A
H	E	R	O	I	N	A		O	V	E	R
S	A	S	S	N	R	V		R	T		
U	T	S	H	T	E	T	E	R	O	R	E
B	L	I	T	E	R	A	T	U	R	A	T
K	A	L	O	R	E	S	I	T	H	A	V
C	A	R	I	S	T	I	N	T	L		
V	H	I	M	I	M	I	K	E			
R	A	M		E	T	N	A	A	R	R	
A	D	R	E	S	E	I	T	A	L	I	A
P	O	L	E	M	I	K	A	S	E	A	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	T	A		H	E	L	M	E	T		
A	R	R		V	E	D		D	E	P	P	
P	A	R	A	L	E	L	E	T	L	E	R	
P	O	L	I	F	E	M	I	O	L	E		
E	M	I	L	E	Z	O	L	A	E	T	I	K
L	A	I	R	A	E		R	R	E	Z	E	
E	R	A	I	B	E	M	R	I	I	S		
H	I	M	A	E	S	T	R	O	D	E		
T	A	L	E	N	T	E	T	A	R	E		
E	K	R	A	H	O	R	A	R	I	A		
S	I	P	R	I	T	A	T	R				
K	A	P	A	N	O	N	E	T	L	A	L	A
D	I	S	K	O	T	E	K	A	T	A	P	
R	O	M	A	N	A	R	G	O	S	A		
E	N	T	G	N	I	R	H	R				
W	M	O	N	O	G	R	A	F	I	A	A	
P	E	L	E	G	R	I	N	A	Z	H	E	T
P	O	L	I	G	L	O	T	E	T	I	D	E
A	L	K	R	A	H	E	T	K	S	H	T	
K	E	N	I	T	T	K	A	T	E	R		
K	E	M	I	L	E	S	T	O	M	E	R	
T	I	M	E	R	S	T	A	N	E	T	I	
A	K	S	E	R	I	O	Z	N	R	A	M	
T	E	O	T	R	A	Z	J	A	R	R	I	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Nuk ka vlerë të thoni "ne po bëjmë më të mirën që mundemi". Sukseset arrihen duke bërë atë që është e nevojshme. (Uinston Curcill)
- Nuk mund t'ju jap formulën e suksesit por mund t'ju jap formulën se si mund të dështoni: përpqini të kënaqni çdo njeri. (Herbert Bajard Suop)
- Kujdesi shpie në përjetshmëri, moskujdesi në vdekje; të kujdesshmit nuk vdesin kurrë, të pakujdesshmit janë si të vdekur.
- Thellohuni vetëm të njëra. Cila? Te dhembshuria e madhe. Kushdo që ka shumë dhembshuri, ka të gjitha cilësitë e Budës në pëllëmbën e dorës.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

